




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



VLERËSIMI I QYTETARËVE MBI SHËRBIMET E GJYKATAVE THEMELORE



VLERËSIMI I QYTETARËVE MBI SHËRBIMET E GJYKATAVE THEMELORE

Prishtinë, Prill 2020



Mohim i përgjegjësishë:

Ky botim u krijua për shqyrtim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ky dokument u përgatit nga Demokracia Plus dhe Qendra e Avokuese për Kulturë Demokratike. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdo pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	6
GJETJET KRYESORE	7
1. HYRJE.....	8
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	10
2.1. Anketa.....	10
2.2. Variablat e studiuara	14
2.2.1. Qasja në informacion publik	14
2.2.2. Efikasiteti.....	14
2.2.3. Korrupsioni	15
2.3 Të dhëna demografike	15
2.4 Diskutimet në fokus grupe	20
3. QASJA NË INFORMATA	22
3.1. Qasja në informacion rreth rasteve.....	22
3.2. Dobia e informacionit të siguruar nga gjykata	23
3.3. Përdorimi i faqes së internetit të gjykatës për qasje në informacion	29
3.4. Rangimi i përgjithshëm i gjykatave për qasjen në informata.....	32
4. EFIKASITETI DHE TRAJTIMI I DREJTË.....	34
4.1. Efikasiteti i gjykatës	34
4.2. Trajtimi në gjykatë.....	39
4.3. Përdorimi i gjuhës amtare.....	43
4.4. Rangimi i përgjithshëm i efikasitetit dhe paanësisë.....	50
5. PREVALENCA E KORRUPSIONIT	52
5.1. Ryshfeti	52
5.2. Renditja e përgjithshme e gjykatave për prevalencën e korrupsionit	59
6. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM	60
7. REKOMANDIME KONKRETE PËR SECILËN GJYKATË THEMELORE	61
SHTOJCA	66

LISTA E SHKURTESAVE

ACDC

Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike

CAPI

Intervistimi Personal i Asistuar nga Kompjuteri

D+

Demokraci Plus

DFG

Diskutimet në Fokus Grupe

JSSP

Programi për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë

KGJK

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

USAID

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

GJETJET KRYESORE

Qasja në informacion

- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në secilën prej shtatë gjykatave themelore treguan se ishte e lehtë të i qaseshin informacionit në lidhje me lëndët e tyre.
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në secilën gjykatë themelore pretenduan se informacioni i marrë nga gjykatat ishte paksa i dobishëm ose shumë i dobishëm.
- Shumica dërrmuese e përdoruesve të shërbimeve të secilës gjykatë themelore deklaruan se ishte shumë e lehtë t'a gjenin sallën e gjyqimeve ose zyrën që e kërkonin.
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës në secilën gjykatë themelore nuk e dinin nëse në ambientet e gjykatës kishte kuti për ankesa.
- Si të përdoruesit e shërbimeve të gjykatave të anketuar ashtu edhe pjesëmarrësit në diskutimet e fokus grupeve (DFG) thanë se kishte tavolina për informim, por pjesëmarrësit në DFG treguan se shpesh askush nuk gjendej në ato tavolina.
- Shumica dërrmuese e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave, si nga komuniteti shumicë ashtu edhe nga ato joshumicë, nuk e përdorin si burim informacioni faqen e internetit të gjykatës.
- Përdoruesit e shërbimeve të gjykatave nga komunitetet joshumicë pohuan se faqet e internetit të gjykatave janë të përkthyer në gjuhën e tyre amtare, por që cilësia e përkthimit duhet të përmirësohet.

Efikasiteti dhe trajtimi i drejtë

- Shumica e përdoruesve të shërbimeve në Gjykatën Themelore të Pejës dhe asaj të Prizrenit nuk ishin në gjendje t'i kryenin punët e tyre brenda një kohe të arsyeshme.
- Nëpër të gjitha gjykatat themelore, shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës treguan se lëndët e tyre kanë qenë aktive për më pak se dy vjet.

doruesve të shërbimeve të gjykatës treguan se lëndët e tyre kanë qenë aktive për më pak se dy vjet.

- Përdoruesit e shërbimeve në gjykata themelore, përveç asaj të Prishtinës dhe Prizrenit janë ndierë deri diku të kënaqur lidhur me kohëzgjatjen e shqyrtimit të lëndëve të tyre. Ndërkaq, përdoruesit e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Prizrenit janë shprehur se janë shumë të pakënaqur.
- Përdoruesit e gjykatave nga komunitetet shumicë dhe joshumicë kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë të drejtë dhe me respekt nga stafi i gjykatës.
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës gjithashtu besojnë që janë trajtuar në mënyrë të drejtë nga gjyqtarët.
- Gratë pjesëmarrëse në DFG që kanë pasur qasje në shërbimet e gjykatave në Pejë, Gjiilan dhe Gjakovë, janë ndierë të diskriminuara në baza gjinore nga ana e gjyqtarëve.
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave që nuk e flasin gjuhën shqipe kanë qenë në gjendje ta flasin gjuhën amtare në seancat gjyqësore dhe në bashkëveprim me personelin e gjykatës.
- Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave kanë treguar se nuk kanë qenë të informuar për të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë disiplinore kundër ndonjë gjyqtari.

Prevalenca e Korrupsionit

- Të gjeturat e anketës treguan se as personeli i gjykatës dhe as përdoruesit e shërbimeve të gjykatës nuk kishin kërkuar ose ofruar ryshfete në asnjë nga shtatë gjykatat themelore.
- Pjesëmarrësit në DFG besonin se kur ndodh korrupsioni ajo është një formë e shkëmbimit të favoreve ndërmjet akterëve të brendshëm dhe të jashtëm, dhe se nuk është formë e ryshfetit.

1. HYRJE

Kjo anketë është dizajnuar dhe realizuar nga Demokraci Plus (D+) në partneritet me Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) për të siguruar informata dhe të dhëna nga qytetarët për performancën e shtatë gjykatave themelore të Kosovës. Me kerkese të Programit për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP), kjo anketë është vazhdimësi e studimit të Vlerësimit të Qytetarëve për Shërbimet e Gjykatave Themelore i kryer në vitin 2018, i cili gjykatave u ofroi të njëjtat informata të qytetarëve që ta përmirësojnë efikasitetin dhe reputacionin. Studimi aktual përdor kombinimin e metodave hulumtuese sasiore (anketën) dhe cilësore (diskutime në fokus grupe) për të marrë përvojën e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës në rrafsh të ndryshme të ofrimit të shërbimeve të gjykatave. Rezultatet gjithashtu sigurojnë matjen e perceptimit lidhur me cilësinë e shërbimeve në të gjitha gjykatat themelore. Ky hulumtim është i menduar që gjykatave themelore, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe organeve tjera gjyqësore t'u ofrojë të dhëna të artikuluar për veprim lidhur me gjendjen e qasjes në informata, efikasitet dhe trajtim të barabartë të palëve, prevalencën e korrupsionit brenda gjykatave themelore, si dhe rekomandime për t'u përmirësuar, të bazuara në të dhëna.

Programi i USAID për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë është program pesëvjeçar për sundim të ligjit, i cili bazohet në përpjekjet e mëparshme të USAID-it për ta avancuar këtë sektor në Kosovë dhe për t'u siguruar që sistemi i drejtësisë të funksionojë në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënëse. Programi përqendrohet në promovimin e një sistemi gjyqësor që i përmbahet standardeve më të larta të pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës, si dhe në mbështetjen e funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në veri të Kosovës.

Ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në ndarjen e drejtësisë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore

Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP), përmes USAID-it, ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat e Kosovës në konsolidimin e përfitimeve në efikasitet dhe menaxhim në nivelin e gjykatave. Kjo është arritur duke lehtësuar decentralizimin e kompetencave administrative dhe institucionalizimin e sistemeve dhe instrumenteve për menaxhimin efektiv të lëndëve dhe gjykatave. Aktivitetet sipas këtij objektiv zvogëlojnë numrin e lëndëve të vjetra dhe pengesat procedurale për efikasitetin dhe efektivitetin e gjykatës.

Përmirësimin e llogaridhënies dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë

JSSP-ja punon ngushtë me KGJK-në, gjykatësit dhe stafin e gjykatës në ngritjen e kapaciteteve për të ofruar drejtësi në mënyrë profesionale dhe efikase. Gjithashtu promovon arsimimin e vazhdueshëm dhe iniciativat e integritetit publik si themele për një gjyqësor të qasshëm, të besueshëm dhe efektiv.

Mbështetjen e funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në veri

JSP-ja mbështet KGJK-në dhe gjykatat në aktivizimin e strukturave gjyqësore në veri të Kosovës, bazuar në Marrëveshjen për Sektorin e Drejtësisë nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vitin 2015. Kjo marrëveshje parasheh integrimin e institucioneve, funksionimin e gjykatave dhe burimeve gjyqësore në veri. JSP-ja gjithashtu ndihmon gjykatat përkatëse në rajon me inventarë të lëndëve dhe transferimet, zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara, menaxhimin e lëndëve dhe ndërtimin e kapaciteteve për gjyqtarët dhe stafin e gjykatës.

Demokrasi Plus është organizatë e pavarur, jofitimprure dhe jopartiake, e themeluar nga një grup aktivistësh që besojnë në forcimin e mëtejshëm të vlerave demokratike në Kosovë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike që do të forcojnë më tej zërin e shoqërisë kosovare. D+ synon të kontribuojë në krijimin e praktikave të qeverisjes së mirë, forcimin e sundimit të ligjit, mbështetjen e zgjedhjeve të lira e të ndershme, nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe çështjeve sociale. D+ ka sendërtuar projekte të ndryshme që synojnë t'i sjellin vendimmarrësit më afër qytetarëve përmes hulumtimit të politikave, lehtësimit të dialogut dhe ndërveprimit dhe edukimit publik.

Qendra e Avokatisë për Kulturë Demokratike është organizatë e shoqërisë civile me seli në Mitrovicën e Veriut. ACDC -ja synon të përmirësojë angazhimin e popullatës shumëetnike në rajonin e Mitrovicës dhe të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për kulturë demokratike.

“

Madhësia e mostrës përfshin 1,307 përdorues të gjykatave, nga të cilët 333 janë nga komunitetet joshumicë. Madhësitë e mostrës për secilën gjykatë themelore janë llogaritur bazuar në numrin e rasteve aktive në këto gjykata. Kriteret e përcaktuara statistikore janë aplikuar me një interval besueshmërie prej 95% dhe një marzhë gabimi +/- 10%.

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1 Anketa

Në muajt shtator-tetor të vitit 2019, D+ dhe ACDC kishin kryer anketa dalëse me 1,307 të anketuar të cilët kanë lëndë aktive në gjykatat themelore dhe në kohën kur ishin intervistuar ishin duke kërkuar shërbime të gjykatave. 974 nga të anketuarit vinin nga komuniteti shumicë, ndërsa 333 nga komunitetet jo-shumicë. Ky hulumtim është vazhdimësi e studimit të mëparshëm të realizuar nga D+ në vitin 2018 ¹, i cili ishte ndërmarrë për të vlerësuar përvojën e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës dhe perceptimit të tyre për qasje në informacione publike, efikasitetin dhe korrupsionin në shtatë gjykatat themelore të Kosovës.

Që nga qershori i 2019-ës (kur ishte përcaktuar mostra), në gjykatat themelore kishte gjithsej 133,011 lëndë të grumbulluara dhe në pritje. Gjykata Themelore e Prishtinës kishte numër më të madh të lëndëve (75,867) sesa të gjitha gjykatat tjera themelore së bashku (57,144). D+ dhe ACDC, përmes këtij studimi, kanë tentuar që të përcaktojnë nëse gjykatat me numrin më të madh të lëndëve a perceptoheshin si më pak efikase ose transparente dhe se a shiheshin si më të korruptuara se gjykatat e tjera.

Për shkak të konfidencialitetit dhe çështjeve të mbrojtjes së të dhënave personale, studimit i mungon një kornizë e mostrës për popullatën në fjalë (d.m.th. një listë e plotë e përdoruesve të gjykatës prej së cilës mund të përzgjedheshin rastësisht pjesëmarrësit e anketës). Në mungesë të saj, si kornizë e marrjes së mostrave ishin përdorur lëndët në inventar.

1 Osmani, R. (2018). Vlerësimi i qytetarëve për shërbimet në gjykatat themelore. Marrë nga <http://bit.ly/2RztpDg>.

TABELA 2.1.1: LËNDËT E PAZGJIDHURA PËR SECILËN GJYKATË THEMELORE

GJYKATA THEMELORE	NGARKESA E GJYKATËS ME LËNDË /POPULLSIA (N)
	PRISHTINË  75,867
	FERIZAJ  12,030
	GJILAN  8,209
	PRIZREN  12,134
	GJAKOVË  7,672
	PEJË  8,128
	MITROVICË  8,971

Totali 133,011

Mostra e përdorur në këtë anketë përbëhet nga dy mostra në madhësi të pavarur. Mostra e parë prej 1.000 të anketuarve ka matur përvojat e shqiptarëve të Kosovës të cilët kishin lëndë aktive në gjykatat themelore. Nga mostra e përgjithshme, mostrat me madhësi minimale janë llogaritur për secilën gjykatë themelore, duke marrë për bazë numrin e lëndëve të grumbulluara në secilën gjykatë. Kriteret standarde statistikore janë aplikuar me interval besueshmërie 95% dhe marzhë gabimi prej +/- 10%. Kriteret e përcaktuara statistikore nxorën një madhësi të mostrës thujse identike për secilën gjykatë themelore, me një mostër totale të të gjitha gjykatave themelore e barabartë me 666 (shih tabelën 2.1.2 kolonën 3 si më poshtë). Duke pasur parasysh që madhësia e paracaktuar e mostrës ishte 1.000, atëherë 334 vrojtimit e mbetura janë shpërndarë në secilën gjykatë themelore në proporcion me numrin e lëndëve në inventar (shih tabelën 2.1.2, kolona 4), në këtë mënyrë duke rregulluar madhësinë e përgjithshme të mostrës për secilën gjykatë themelore (Tabela 2.1.2, kolona 6).

TABELA 2.1.2: LLOGARITJA E MADHËSISË SË MOSTRËS PËR SECILËN GJYKATË

	Gjykata Themelore	Inventari i lëndëve në gjykatë / Popullsia (N)	Madhësia e mostrës 10% Me G dhe 95% IB	Shtesa Proporcionale	Madhësia e llogaritur e mostrës	Madhësia aktuale e mostrës
	Prishtinë	75,867	96	191	287	277
	Ferizaj	12,030	95	30	125	124
	Gjilan	8,209	95	21	116	109
	Prizren	12,134	95	30	125	123
	Gjakovë	7,672	95	19	114	112
	Pejë	8,128	95	20	115	113
	Mitrovicë	8,971	95	23	118	116
TOTALI		133,011	666	334	1000	974

Madhësia e dytë e mostrës ishte përlogaritur për të mbledhur të dhëna mbi përvojën e komuniteteve joshumicë me shërbimet e gjykatave themelore. Megjithatë të dhënat për lëndët në inventar të paraqitura në faqen e internetit të KGJK-së nuk e tregojnë prejardhjen etnike të palëve në procedurë, KGJK-ja na e ofroi numrin e lëndëve aktive për secilën gjykatë themelore përfshirë edhe palët nga komuniteti joshumicë. Ky numër shërbeu si kornizë e mostrës nga e cila kemi llogaritur një mostër përfaqësuese të komuniteteve joshumicë. Tabela 2.1.3 si më poshtë shfaq numrin e lëndëve aktive të palëve nga komunitetet joshumicë, madhësinë e mostrës së llogaritur ishte mbështetur në të njëjtat kritere statistikore (intervali i besueshmërisë 95% dhe marzha e gabimit prej +/- 10%), dhe madhësia aktuale e mostrës² për gjykatë themelore.

TABELA 2.1.3: KORNIZA DHE MADHËSIA E MOSTRËS PËR KOMUNITETET JOSHUMICË PËR SECILËN GJYKATË

	Gjykata Themelore	Inventari i lëndëve në gjykatë /Popullsia (N)	Madhësia e llogaritur e mostrës	Madhësia aktuale e mostrës
	Prishtinë	2,750	93	57
	Mitrovicë	500	81	89
	Pejë	325	75	77
	Prizren	590	83	42
	Ferizaj	220	68	9
	Gjilan	179	63	28
	Gjakovë	40	29	31
TOTALI		4,604	492	333

2 Madhësia e mostrës së arritur për kohën e ndarë për mbledhjen e të dhënave.

Mbledhja e të dhënave nga D+ dhe ACDC ishte bërë përmes sondazhit, i cili ishte administruar në të dy gjuhët zyrtare të Kosovës: shqip dhe serbisht. Për t'u siguruar që të dhënat ishin mbledhur nga përdoruesit e gjykatave si nga komuniteti shumicë ashtu edhe nga ai joshumicë, ishin përdorur dy teknika të ndryshme të mbledhjes së të dhënave. Të anketuarit nga komuniteti shumicë ishin përzgjedhur bazuar në një teknikë sistematike e marrjes së mostrave, me çdo të tretin person që dilte nga ndërtesa e gjykatës. Për të përzgjedhur të anketuarit e komunitetit joshumicë, regjistruarit tanë kanë intervistuar persona që dilnin nga ndërtesa e gjykatës dhe që identifikoheshin se i përkisnin një komuniteti joshumicë. Si rrjedhojë, dy regjistruarit qëndronin në dalje të secilës ndërtesë të gjykatave themelore, të cilët i anketonin pasi të njëjtit dakordoheshin për një gjë të tillë.

Periudha kohore për mbledhjen e të dhënave ndryshon. Regjistruarit që kanë mbledhur të dhëna nga komuniteti shumicë kanë qëndruar para ndërtesave të gjykatave themelore për një muaj, derisa është arritur numri i paracaktuar i të anketuarve. Regjistruarit për komunitetet joshumicë, gjithashtu kanë qëndruar para ndërtesave të gjykatave themelore për një muaj dhe kanë anketuar aq sa ka lejuar shpeshtësia e qarkullimit të marrësve të shërbimeve të gjykatës nga komuniteti joshumicë që vizitonin gjykatat. Studimi bazuar në këtë metodë kishte gjithsej 974 përgjigje nga përdoruesit e gjykatave të komunitetit shumicë dhe 333 përgjigje nga përdoruesit e gjykatave nga komunitetet joshumicë.

Pyetësi përmbante pyetje identike në të dy gjuhët, dhe ishte hartuar për të marrë pikëpamje mbi aspektet që kishin të bënin me komunitetin shumicë dhe komunitetet joshumicë. Pyetësi përfshinte gjithashtu një mori pyetjesh të përqendruara kryesisht në çështje që kishin të bënin me komunitetet joshumicë. Të dhënat për këto pyetje janë paraqitur dhe analizuar veçmas, ndërsa të dhënat për pyetjet që kishin të bënin me çështjet e zakonshme janë bashkuar nga të dyja sondazhet dhe interpretuar si përfaqësim i përgjithshëm i të gjithë marrësve të shërbimeve të secilës gjykatë. Gjetjet mund të përdoren për të nxjerrë përfundime statistikore për tërë popullatën e marrësve të shërbimeve të këtyre gjykatave.

2.2 Variablat e studiuar

2.2.1. Qasja në informacion publik

Qasja në informacion, për qëllime të këtij studimi matet duke mbledhur të dhëna për përvojën e përdoruesve të gjykatës lidhur me: (1) lehtësinë e marrjes së informacionit të nevojshëm për lëndët e tyre nga gjykata ku gjykohet çështja e tyre, (2) dobinë e informacionit të dhënë nga gjykata; (3) gjetjen / vendndodhjen e zyrës së caktuar ose gjykatores; (4) përdorimi i faqes së internetit të gjykatës për të marrë informacionin e nevojshëm; dhe (5) dobinë e përmbajtjes faqes së internetit të gjykatës.

2.2.2. Efikasiteti

Efikasiteti i gjykatave themelore matet nga këndvështrimi i përdoruesit të gjykatës bazuar në: (1) kohën që merr për të përfunduar një punë në gjykatë dhe nëse ishte e arsyeshme në ditën kur të anketuarit po anketohehin; (2) kohën që lënda e tyre ka mbetur në pritje; (3) kënaqshmërinë me gjyqtarë dhe stafin e administratës së gjykatave për sa i përket trajtimit të drejtë dhe të barabartë; (4) mundësinë e përdorimit të gjuhës amtare dhe kënaqshmëria me cilësinë e përkthimit gjatë seancave gjyqësore. Është me rëndësi të theksohet se, ky studim vlerëson efikasitetin e gjykatave nga këndvështrimi i përdoruesve të shërbimeve të gjykatës dhe nuk ka për qëllim të matë efikasitetin e përcaktuar sipas matjeve të standardizuara institucionale.

2.2.3. Korrupsioni

Variabla e korrupsionit është matja e përvojës së përdoruesve të shërbimeve të gjykatës nëse ju ishte kërkuar ryshfet ose nëse kishin ofruar ryshfet për stafin e gjykatave. Këto dy pyetje kryesore ishin pasuar nga dy nënpyetje, ku secila lëshohej në arsyet pse kishte ndodhur ky shkëmbim (nëse kishte ndodhur) dhe pozitën që e kishte punonjësi i gjykatës.

2.3 Të dhëna demografike

Të dhënat demografike të pjesëmarrësve në studim mund t'i gjeni në tabelat si më poshtë. Të dhënat demografike paraqiten veçmas për përdoruesit e shërbimeve të gjykatave nga komunitetet shumicë dhe joshumicë. Të anketuarit nga komuniteti shumicë ishin 89.6% burra dhe 10.4% gra. Të anketuarit e komunitetit joshumicë ishin 80.4% burra dhe 20.6% gra. Zbërthimi i të anketuarave në aspektin gjinor për secilën gjykatë mund të shihet në tabelën si më poshtë.

TABELA 2.2.4.1: PJSËMARRËSIT NË HULUMTIM SIPAS GJINISË, SIPAS REGJIONIT

		Komuniteti shumicë		Komunitetet joshumicë	
					
		Burra	Gra	Burra	Gra
	Prishtinë	83%	17%	88%	12%
	Mitrovicë	97%	3%	79%	21%
	Pejë	97%	3%	65%	35%
	Prizren	93%	7%	90%	10%
	Ferizaj	92%	8%	78%	22%
	Gjilan	95%	5%	96%	4%
	Gjakovë	77.68%	22.32%	83.87%	16.13%
Totali		 87% Burra	 13% Gra		

Shumica e të anketuarve nga komuniteti shumicë dhe joshumicë ishin të moshës mes 35 deri 44 vjeç.

TABELA 2.2.4.2: GRUPMOSHA E TË RESPONDENTËVE, SIPAS RAJONIT

		KOMUNITETI SHUMICË						KOMUNITETI JOSHUMICË					
		18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
	PRISHTINË	11.19%	29.24%	23.10%	14.80%	12.64%	9.03%	7.02%	22.81%	26.32%	28.07%	8.77%	7.02%
	MITROVICË	12.07%	20.69%	19.83%	25.86%	16.38%	5.17%	6.74%	35.96%	38.20%	12.36%	3.37%	3.37%
	PEJË	1.77%	1.77%	23.89%	46.90%	11.50%	14.16%	1.30%	11.69%	9.09%	25.97%	29.87%	22.08%
	PRIZREN	13.01%	18.70%	23.58%	20.33%	16.26%	8.13%	9.52%	11.90%	7.14%	30.95%	19.05%	21.43%
	FERIZAJ	9.68%	28.23%	36.29%	15.32%	7.26%	3.23%	22.22%	0.00%	55.56%	11.11%	11.11%	0.00%
	GJILAN	12.84%	25.69%	24.77%	21.10%	13.76%	1.83%	3.57%	10.71%	28.57%	7.14%	32.14%	17.86%
	GJAKOVË	6.25%	21.43%	16.07%	22.32%	20.54%	13.39%	0.00%	16.13%	22.58%	35.48%	25.81%	0.00%

Meqenëse studimi synon të marrë pikëpamjet e të gjitha komuniteteve që marrin shërbime nga gjykatat themelore, gjithashtu ishin mbledhur edhe të dhëna demografike për përkatësinë etnike. Shumica dërrmuese e të anketuarve në shtatë gjykatat themelore ishin nga komuniteti shqiptar, pasqyrim i popullsisë së Kosovës dhe vëllimit të lëndëve që ata kanë në gjykatat themelore. Nga komunitetet joshumicë, komuniteti serb përfaqëson numrin më të madh të të anketuarve me (169), pasuar nga boshnjak (110), rom (20), ashkalinj (14), egjiptian (8), goran (7) dhe turq (3).

TABELA 2.2.4.3: PËRKATËSIA ETNIKE E RESPONDENTËVE



	Shqiptar	Serb	Turq	Boshnjak	Rom	Ashka- linj	Egjiptian	Goran	Të tjerë
 Prishtinë	82.93%	11.68%	0.00%	1.20%	0.90%	1.50%	0.00%	1.20%	0.60%
 Mitrovicë	56.59%	36.10%	0.00%	5.37%	1.46%	0.49%	0.00%	0.00%	0.00%
 Pejë	59.47%	8.95%	0.00%	30.53%	1.05%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
 Prizren	74.55%	1.82%	1.21%	20.61%	0.00%	0.00%	0.00%	1.82%	0.00%
 Ferizaj	93.23%	6.02%	0.00%	0.75%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
 Gjilan	79.56%	20.44%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
 Gjakovë	78.32%	0.00%	0.70%	1.40%	8.39%	5.59%	5.59%	0.00%	0.00%
Totali	974	169	3	110	20	14	8	7	2

Përdoruesve të shërbimeve të gjykatës ju kërkua të deklaronin arsyen pse po vizitonin objektin e gjykatës, nëse pohonin se kishin lëndë aktive, atyre ju kërkohet të zgjidhnin midis katër mundësive dhe ato si: paditës, i pandehur, i akuzuar apo si viktimë³. Shumica e të anketuarve nga komuniteti shumicë ishin paditës (356 nga 971), pastaj të pandehur (227 nga 971), të akuzuar (276) dhe viktimë (112). Grupi më i madh nga komunitetet joshumicë ishin viktimë (98 nga 331), ndjekur nga të pandehur (86), të akuzuar (75) dhe paditës (72), ndërsa pesë të anketuar kishin refuzuar të përgjigjeshin në këtë pyetje.

Sa i përket llojit të lëndëve, të anketuarit e komunitetit joshumicë që ju përgjigjen kësaj pyetje, shumica kishin pasur lëndë civile (400 të anketuar), të ndjekur nga procedura penale (281) dhe kundërvajtje (156). Ndërsa të anketuarit e komuniteteve joshumicë, me përjashtim të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, ku shumica e të anketuarve e kishin vizituar objektin e gjykatës për lëndë penale (73 të anketuar), kishin edhe lëndë tipike civile (118 nga 333 të anketuar).

3 Terminologjia për palët në procedurë ndryshon në varësi të llojit të lëndës; për lëndët civile: paditës dhe i paditur, ndërsa për lëndët penale: i akuzuar dhe viktimë.

2.4. DISKUTIMET NË FOKUS GRUPE

D+ dhe ACDC kanë zhvilluar tetë Diskutime në Fokus Grupe (DFG) me përdoruesit e shërbimeve në të shtatë gjykatat themelore. Një DFG shtesë ishte organizuar me komunitetet joshumicë në Mitrovicën e Veriut. Të njëjtat kritere si për pjesëmarrjen në anketë ishin zbatuar në përzgjedhjen e pjesëmarrësve për DFG. Kështu, të gjithë të pranishmit ishin qytetarë që kishin qenë pjesëmarrës në procedurë gjyqësore. Qëllimi i DFG-ve ishte hulumtimi i hollësishëm i variablave dhe vërtetimi i gjetjeve të anketës.

TABELA 2.3.1 PROGRAMI I FOKUS GRUPEVE DHE DEMOGRAFIA E PJESËMARRËSVE

VENDNDODHJA	Data	Numri i pjesëmarrësve	Gjinia	
 GJILAN	17 tetor 2019	11	 7	 4
 GJAKOVË	18 tetor 2019	11	 9	 2
 FERIZAJ	10 tetor 2019	6	 4	 2
 PEJË	24 tetor 2019	16	 6	 10
 MITROVICË	25 tetor 2019	8	 1	 7
 PRIZREN	1 nëntor 2019	13	 6	 7
 PRISHTINË	8 nëntor 2019	6	 0	 6
MITROVICË e Veriut	13 nëntor 2019	10	 3	 7
Total		81	 36	 45

Pjesëmarrësit ishin rekrutuar nga të shtatë regjionet në bashkëpunim me OJQ-të vendore sipas kriterit që ata të ishin palë në procedurë gjyqësore (paditës, mbrojtës, i akuzuar, viktimë) në gjykatën themelore përkatëse. Secila DFG fillonte ashtu që pjesëmarrësit prezantoheshin me emër dhe me llojin e lëndës që së fundmi i kishte sjellë ata në gjykatë. Pjesëmarrësve u ishte ofruar anonimitet i plotë dhe moderatori i kishte siguruar që të dhënat e mbledhura do të përdoreshin vetëm për qëllimet e këtij studimi. Diskutimi ishte drejtuar nga tri fusha tematike të këtij studimi: qasja në informacion, efikasiteti dhe korrupsioni, dhe pyetjet që rrodhën nga studimi dhe rezultatet (shih Shtojcën I). Moderatori u kishte kërkuar pjesëmarrësve të diskutojnë mbi gjetjet e anketës pasuar me pyetje më të hollësishme për të shoshitur çështjet më në imtësi.

3. QASJA NË INFORMATA

3.1. Qasja në informacion rreth rasteve

Kjo pjesë është e ndarë në tri nënpjesë. Pjesa e parë synon të shqyrtojë nëse qytetarët që përdorin shërbime të gjykatave mund të marrin informacione të mjaftueshme në lidhje me lëndët e tyre në mënyrë të përshtatshme dhe informuese. Pjesa e dytë përqendrohet nëse përdoruesit e gjykatave janë në gjendje që brenda ambienteve të gjykatës të gjejnë sallën e gjyqit ose zyrën që u nevojitet. Pjesa e tretë paraqet gjetjet lidhur me dobinë dhe përdorimin e faqes zyrtare të internetit të gjykatës.

Qasja në informacion për lëndën e vet është e drejtë themelore që duhet të gëzojë çdo qytetar. Gjetjet e anketës tregojnë se kanalet e komunikimit ndërmjet palëve në procedurë dhe administratës së gjykatës janë mjaft të lehta. Shumica e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në të gjitha gjykatat e gjetën paksa të lehtë ose shumë të lehtë për të marrë informacion në lidhje me lëndët e tyre. Gjykata Themelore e Ferizajt qëndron më së miri në këtë drejtim, me shumicën e të anketuarve që konsiderojnë se procesi i marrjes së informacionit për lëndën e tyre ishte shumë i lehtë. Nga ana tjetër, Gjykata Themelore e Prizrenit ka pjesën më të madhe të përdoruesve të shërbimeve të gjykatës, të cilët kur u pyetën për përvojën e tyre me marrjen e informacionit për lëndën e tyre, e zgjedhën opsionin shumë vështirë.

TABELA 3.1: NGA PËRVOJA E JUAJ SA ËSHTË E LEHTË TË MERRNI INFORMACION PËR LËNDËN TUAJ?⁴

		Shumë vështirë	Deri diku vështirë	Deri diku lehtë	Shumë lehtë
	Prishtinë	22.16%	12.28%	47.01%	18.56%
	Mitrovicë	7.80%	20.49%	46.34%	25.37%
	Pejë	1.05%	7.89%	81.05%	10.00%
	Prizren	38.18%	13.33%	24.24%	24.24%
	Ferizaj	0.75%	7.52%	39.85%	51.88%
	Gjilan	29.20%	16.79%	23.36%	30.66%
	Gjakovë	1.40%	25.87%	45.45%	27.27%

⁴ Të dhënat në këtë pyetje janë grumbulluar si nga anketat e shumicës ashtu edhe nga ato joshumicë dhe interpretohen nga këndvështrimi i përdoruesit, i pavarur nga prejardhja e tij.

Këto gjetje më tej janë shoshitur në DFG-të, ku pjesëmarrësit jo gjithëherë ishin pajtuar me gjetjet e anketës. Për shembull, pjesëmarrësit e DFG-së në Prishtinë treguan se kanë përjetuar vështirësi në qasje të informacionit, ndërsa pjesëmarrësit nga Gjilani kishin shprehur shqetësime lidhur me procedurat. Pjesëmarrësit nga Mitrovica, Peja, Prizreni, dhe Gjakova raportuan se informacionet për lëndët e tyre zakonisht i kishin kërkuar përmes avokatëve të tyre.

3.2. DOBIA E INFORMACIONIT TË SIGURUAR NGA GJYKATA

Përdoruesit e gjykatave në përgjithësi mendonin se gjykatat siguronin informacione të qarta dhe të kuptueshme. Shumica e të anketuarve në përgjithësi dhe në secilën gjykatë themelore konsideruan se informacionet e dhëna ishin ose deri diku të dobishme (56%) ose shumë të dobishme (25%). Në këtë drejtim u dalluan gjykatat themelore të Gjilanit dhe Pejës. Në Gjilan, shumica e të anketuarve menduan se informacioni i dhënë ishte shumë i dobishëm. Në Pejë, pothuajse 95% e të anketuarve vlerësuan se informacionet e dhëna ishin deri diku ose shumë të dobishme. Nga ana tjetër, pothuajse gjysma e përdoruesve të shërbimeve të ofruara nga Gjykata Themelore e Prizrenit, pretenduan se i konsiderojnë informacionet si shumë ose deri diku të dobishme.

TABELA 3.2: SA I DOBISHËM ISHTE INFORMACIONI I OFRUAR NGA GJYKATA?

		Shumë i pado- bishëm	Deri diku i pado- bishëm	Deri diku i do- bishëm	Shumë i do- bishëm
	Prishtinë	21.26%	11.38%	46.11%	21.26%
	Mitrovicë	5.85%	14.63%	47.32%	32.20%
	Pejë	1.58%	3.68%	83.16%	11.58%
	Prizren	33.94%	12.12%	27.88%	26.06%
	Ferizaj	0.75%	2.26%	60.90%	36.09%
	Gjilan	16.06%	1.46%	30.66%	51.82%
	Gjakovë	3.50%	16.08%	60.84%	19.58%

Pjesëmarrësit në DFG vunë në pah se kishin përjetuar disa probleme me informacionet e ofruara. Pjesëmarrësit nga Prishtina treguan se informacionet që i merrnin shpesh u mungonte struktura e qartë, ndërsa ata nga Mitrovica shprehën shqetësimet e tyre lidhur me cilësinë e përkthimeve. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në DFG nga komunitetet joshumicë nuk i kishin të njëjtat preokupime lidhur me përkthimet siç i kishin kolegët e tyre në Mitrovicë, ata shprehën shqetësimet e ngjashme lidhur me specifikat dhe saktësinë e informacionit, sikurse kolegët e tyre në Prishtinë.

Të anketuarit në anketë gjithashtu ishin pyetur lidhur me përvojën e tyre në gjetjen e sallave të gjykimit apo zyrave që u duheshin ditën kur e kishin vizituar godinën e gjykatës. Pothuajse rreth 90% e të anketuarve (1153 nga 1307) treguan se gjetja e lokacionit të kërkuar ishte deri diku i lehtë. Përdoruesit e shërbimeve në gjykatat themelore të Ferizajt dhe Prizrenit dolën përtej 80%, ku të anketuarit pohuan se kishte qenë shumë e lehtë për ta gjetur zyrën/sallën e gjykimit që ata po e kërkonin.

TABELA 3.3: CILA ISHTE PËRVOJA JUAJ NË GJETJEN E SALLËS NË GJYKATË OSE ZYRËS QË JU DUHEJ?

		Shumë vështirë	Deri diku vështirë	Deri diku lehtë	Shumë lehtë
	Prishtinë	10.18%	8.98%	52.10%	28.74%
	Mitrovicë	5.85%	10.24%	36.59%	47.32%
	Pejë	0.53%	1.05%	27.37%	71.05%
	Prizren	6.67%	3.03%	10.30%	80.00%
	Ferizaj	1.50%	5.26%	9.77%	83.46%
	Gjilan	14.60%	0.73%	5.11%	79.56%
	Gjakovë	0.00%	5.59%	44.06%	50.35%

Kjo pyetje u pasua nga një pyetje e hapur për pjesëmarrësit që shprehnin vështirësi në gjetjen e sallës në gjykatë ose zyrës, të jepnin mendimin se çfarë do t'ua bënte më të lehtë gjetjen e tyre. Siç tregon tabela më poshtë, disa prej atyre që ishin përgjigjur, deklarimet e tyre ndryshonin nga sinjalizimi më i mirë (d.m.th. shigjetat që tregojnë udhëzime) brenda ndërtesës, deri te marrja e ndihmës nga zyrat e pranimit.

ÇARË DO TË ISHTE E DOBISHME NË KËTË DREJTIM?

Numri i përgjigjeve	Burimi i informacionit
 18	Pjesëmarrësit deklaruan se do të përfitonin nga udhëzimet ose përmirësimi i shenjave të cilat do të shpjegonin më mirë se ku ndodhet gjykata;
 12	Pjesëmarrësit thanë që do të përfitonin nga një tavolinë informacioni e organizuar më mirë;
 7	Pjesëmarrësit deklaruan se shpesh kërkonin nga punonjësit e gjykatës që t'i drejtonin drejt sallës së duhur në gjykatë;
 6	Pjesëmarrësit kërkuar që të ketë informacione më gjithëpërfshirës për sallat e gjykimit;

Komentet e ndërlidhura të FDG në shumë mënyra përkonin me gjetjet e anketës. Pjesëmarrësit nga Prishtina raportuan probleme në gjetjen e sallave të gjykimeve dhe zyrave kur nuk kishte njeri në tavolinën e informacionit. Pjesëmarrësit në Mitrovicë theksuan hutinë e shkaktuar nga dy ndërtesa të gjykatës – një në veri dhe një tjetër në jug. Pjesëmarrësit nga gjykatat e tjera themelore thanë se ka qenë shumë e lehtë të gjendet salla e gjykimeve ose zyra që u duhej.

Përderisa, gjykatat themelore kanë kuti ankesash përmes të cilave qytetarët mund të evidentojnë shqetësime për përvojën e tyre me gjykatën, një përqindje e lartë e të anketuarve nuk ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e tyre. Në fakt, 60% e të anketuarve nga Ferizaj dhe 37% nga Peja pretenduan se në ndërtesë të gjykatës nuk kishte kuti ankesash. Vetëm në Gjakovë një shumicë e të anketuarve (55%) konfirmuan disponueshmërinë e kutive të ankesave në objektin e gjykatës.

TABELA 3.4: A JANË KUTITË E ANKESAVE TË DISPONUESHME NË GODINËN E GJYKATËS?

		Po	Jo	Nuk e di
	Prishtinë	27.54%	11.08%	61.38%
	Mitrovicë	20.98%	4.88%	74.15%
	Pejë	0.00%	36.84%	63.16%
	Prizren	33.33%	3.03%	63.64%
	Ferizaj	3.76%	60.15%	36.09%
	Gjilan	40.15%	4.38%	55.47%
	Gjakovë	55.24%	4.20%	40.56%

Përgjigjet nga pjesëmarrësit në DFG ishin në pajtim me gjetjet e anketës në lidhje me kutitë e ankesave. Shumica pretendonin se nuk ishin në dijeni të kutive, dhe shprehnin shqetësime nëse çështjet e tyre do të trajtoheshin edhe po të kishte kuti për ankesa.

Në anketë, respondentët gjithashtu ishin pyetur nëse gjykata themelore e tyre kishte tavolinë të informacionit, ku mund të merrnin informacione lidhur me lëndën e tyre. Shumica e të anketuarve në të gjitha gjykatat (77% ose 1.010 nga 1.307) ishin përgjigjur me po, ndërsa vetëm 23% (297 nga 1.307) ishin përgjigjur me jo ose nuk e di.

TABELA 3.5: A KA TAVOLINË TË INFORMACIONIT NË GODINËN E GJYKATËS?

		Po	Jo	Nuk e di
	Prishtinë	90.12%	1.80%	8.08%
	Mitrovicë	61.95%	1.95%	36.10%
	Pejë	96.84%	0.53%	2.63%
	Prizren	63.64%	3.03%	33.33%
	Ferizaj	94.74%	1.50%	3.76%
	Gjilan	55.47%	4.38%	40.15%
	Gjakovë	63.64%	3.50%	32.87%

Pjesëmarrësit në DFG vunë re se shpesh i marrin përgjigjet që u duhen nga personeli i sigurisë që zakonisht qëndron në hyrje të ndërtesës së gjykatës.

3.3 Përdorimi i faqes së internetit të gjykatës për qasje në informacion

Edhe pse të shtatë gjykatat themelore kanë faqe të internetit funksionale, qytetarët përgjithësisht nuk i përdorin ato si burim informacioni. Tabela më poshtë tregon se vetëm 10% (148 nga 1307) e të anketuarve (si nga komunitetet shumicë ashtu dhe nga ato joshumicë) kishin përdorur faqen e internetit të gjykatës për të marrë informacion. Kjo në mënyrë të konsiderueshme është më e ulët se gjetjet e anketës së D+ në studimin e 2018-së, ku numri i atyre që pretendonin se e përdornin faqen e internetit të gjykatës ishte 17%.⁵ Gjykata Themelore e Gjakovës ka numrin më të madh të të anketuarve që kishin pretenduar të përdornin faqen e saj për informacion (30%), ndërsa asnjë prej përdoruesve të shërbimeve të Gjykatës Themelore të Pejës nuk kishin pretenduar të kenë përdorur këtë burim informacioni. Përdoruesit e gjykatës nga komunitetet joshumicë dhanë përgjigje të ngjashme, ku shumica e tyre nuk i përdorin faqet e internetit të gjykatave kur kërkojnë informacion.

TABELA 3.6: A E PËRDORNI FAQEN E INTERNETIT TË GJYKATËS PËR TË MARRË INFORMACION?

		KOMUNITETI SHUMICË		KOMUNITETI JOSHUMICË	
		Po	Jo	Po	Jo
	Prishtinë	5.42%	94.58%	15.79%	84.21%
	Mitrovicë	9.48%	90.52%	10.11%	89.89%
	Pejë	0.00%	100%	9.09%	90.91%
	Prizren	8.94%	91.06%	0.00%	100%
	Ferizaj	15.32%	84.68%	22.22%	77.78%
	Gjilan	14.68%	85.32%	25.00%	75.00%
	Gjakovë	30.36%	69.64%	25.81%	74.19%

5 Osmani, R. (2018). (2018). Vlerësimi i qytetarëve për shërbimet në gjykatat themelore. Marrë nga faqe 13, <http://bit.ly/2RztpDg>

Gjetjet e DFG ishin në përputhje me ato si më lartë. Vetëm një pjesë e vogël e pjesëmarrësve kishin pretenduar se i përdornin faqet e internetit të gjykatave për t'iu qasur informacioneve, ku ata shprehen shqetësime për saktësinë e informacionit të disponueshëm. Shkuarja personalisht në objektin e gjykatës mbetet mënyra e preferuar për marrjen e informacionit.

Të anketuarit nga komunitetet joshumicë⁶ që pretendonin se e përdornin faqen e internetit të gjykatës ishin pyetur për çështjen e përkthimit të përmbajtjes. Rezultatet treguan se ata të paktë që kishin pohuar se e vizitojnë faqen e internetit të gjykatës, e kishin gjetur përmbajtjen e përkthyer në gjuhën e tyre amtare.

TABELA 3.7: PËRMBAJTJA QË JU DUHET A ËSHTË E PËRKTHYER NË GJUHËN TUAJ AMTARE NË FAQEN E INTERNETIT TË GJYKATËS?

		Po	Në njëfarë mase	Jo
	Prishtinë	100%	0%	0%
	Mitrovicë	100%	0%	0%
	Pejë	100%	0%	0%
	Prizren	0%	0%	0%
	Ferizaj	100%	0%	0%
	Gjilan	100%	0%	0%
	Gjakovë	100%	0%	0%

⁶ Të gjitha këto nënpyetje janë trajtuar me pjesëmarrësit e komunitetit joshumicë të DFG në Mitrovicën e Veriut, megjithatë të gjithë thanë që nuk e përdorin ueb-faqen e gjykatës si burim informacioni.

Pothuajse të gjithë të anketuarit raportuan se ishin të kënaqur ose disi të kënaqur (deri në njëfarë mase) me materialet e përkthyer në dispozicion në faqet e internetit të gjykatës. Vetëm në Mitrovicë dhe Prishtinë, shumica ishte e kënaqur deri në njëfarë shkalle.

TABELA 3.8: A JENI TË KËNAQUR ME CILËSINË E PËRKTHIMIT TË PËRMBAJTJES SË FAQES SË INTERNETIT TË GJYKATËS?

		Po	Jo	Në njëfarë mase
	Prishtinë	33.3%	11.1%	55.6%
	Mitrovicë	33.3%	0.0%	66.7%
	Pejë	71.4%	14.3%	14.3%
	Prizren	0.0%	0.0%	0.0%
	Ferizaj	100.0%	0.0%	0.0%
	Gjilan	85.7%	0.0%	14.3%
	Gjakovë	87.5%	0.0%	12.5%

Sa i përket informacionit që përdoruesit e shërbimeve të gjykatës e kërkojnë në faqen e internetit të gjykatës, shumica e të anketuarve në të shtatë gjykatat themelore (nga të gjitha komunitetet) zgjedhën kryesisht këto tre lloje të informacionit: *orarin e seancave, informacionin kontaktues, lajmet dhe vendimet e publikuara*.

TABELA 3.9: ZAKONISHT, ÇFARË LLOJ INFORMACIONI KËRKONI NË FAQEN E INTERNETIT GJYKATËS?⁷

		Programi i seancave	Informacioni kontaktues	Lajme	Vendime të publikuara	Informata për gjyqtarë
	Prishtinë	19.35%	22.58%	25.81%	12.90%	19.35%
	Mitrovicë	58.33%	4.17%	12.50%	25.00%	0.00%
	Pejë	57.14%	14.29%	0.00%	0.00%	28.57%
	Prizren	11.76%	11.76%	58.82%	17.65%	0.00%
	Ferizaj	13.79%	20.69%	0.00%	58.62%	6.90%
	Gjilan	29.73%	5.41%	5.41%	32.43%	27.03%
	Gjakovë	8.00%	22.00%	23.00%	32.00%	15.00%

3.4 RANGIMI I PËRGJITHSHËM I GJYKATAVE PËR QASJE NË INFORMATA


Gjykatat themelore janë renditur si më poshtë bazuar në nivelin e qasjes në informata, nëpër të cilën kishin kaluar përdoruesit e shërbimeve të tyre, ku 1 është më i mirë se gjykatat e tjera, dhe 7 është relativisht më i dobët se të tjerat. Rezultatet e vlerësimit për secilën gjykatë janë llogaritur duke përdorur pikët mesatare të nxjerra nga numri i përgjigjeve pozitive ose negative që të anketuarit i kanë dhënë në pyetjet më poshtë ⁸. Rezultatet e anketës tregojnë se Gjykata Themelore e Ferizajt renditet relativisht më mirë se gjykatat tjera themelore, e ndjekur pas nga Gjakova dhe Gjilani.

⁷ Në këtë pyetje gjetjet janë grumbulluar si nga anketat me komunitetin shumicë ashtu edhe nga ato jo-shumicë dhe interpretohen nga këndvështrimi i përdoruesve të pavarur nga prejardhja e tyre etnike.

⁸ Sa më shumë përgjigje pozitive në secilën pyetje të marrë gjykata, aq më shumë pikë ka mbledhur: Gjykata Themelore e Prishtinës (21.62 pikë), Prizreni (22.3 pikë), Gjakova (23.11 pikë), Gjilan (23.18 pikë), Ferizaj (23.71 pikë) Mitrovica (25.40 pikë), Pejë (25.47 pikë)

1. Në përvojën tuaj, sa është e lehtë të merrni informacione për lëndën tuaj? 2. Sa i dobishëm ishte informacioni që ju dha gjykata? 3. Çfarë përvoja kishit për të gjetur sallën e gjyimit ose zyrës që ju nevojitej? 4. A janë në dispozicion kutitë e ankesave në godinën e gjykatës? 5. A ka tavolinë informacioni në godinën e gjykatës? 6. A e përdorni faqen e interneti të gjykatës për të marrë informacion? 7. A është përmbajtja që ju nevojitet e përkthyer në gjuhën tuaj amtare në faqen e interneti të gjykatës? 8. A jeni i kënaqur me cilësinë e përkthimit të përmbajtjes së ueb-faqes? 9. Çfarë lloji informacioni zakonisht kërkon në faqen e interneti të gjykatës?

TABLE 3.10 RANGIMI I GJYKATAVE THEMELORE PËR TRANSPARENCË



“

73% e të gjithë të anketuarëve nga të gjitha gjykatat kanë thënë
qe rastet e tyre kanë qenë aktive për më pak se dy vjet

4. EFIKASITETI DHE TRAJTIMI I DREJTË

Kjo pjesë analizon përvojën e të intervistuarve lidhur me efikasitetin dhe trajtimin e drejtë gjatë marrjes së shërbimeve të gjykatës. Të anketuarit janë pyetur nëse kanë qenë në gjendje të kryejnë punët e tyre në kohë të arsyeshme, ditën kur kishin shkuar në gjykatë, kohën që i duhet gjykatës për të zgjidhur lëndën e tyre dhe sa ishin të kënaqur me kohën e zgjidhjes së lëndëve të tyre. Përveç kësaj, kjo pjesë merret edhe me trajtimin e drejtë nga këndvështrimi i përdoruesve të shërbimeve të gjykatës, posaçërisht nëse ata janë ndjerë se ishin trajtuar në mënyrë të barabartë dhe me respekt nga gjyqtarët dhe stafi i gjykatës, dhe nëse përdoruesit e shërbimeve të gjykatave nga komunitet joshumicë ishin në gjendje të përdornin gjuhën e tyre amtare.

4.1. Efikasiteti i gjykatës

Për të vlerësuar përvojën e drejtpërdrejtë të përdoruesve të shërbimeve të gjykatës me efikasitetin e gjykatës, të anketuarit ishin pyetur nëse ishin në gjendje të kryenin punë brenda një kohe të arsyeshme ditën kur kishin shkuar në gjykatë. Përcaktimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes ishte lënë në diskrecionin e secilit të anketuar. Në këtë drejtim, printe Gjykata Themelore e Mitrovicës me 75% e të anketuarve që janë përgjigjur me Po, se kishin qenë në gjendje që punët në gjykatë t'i kryenin brenda kohës së arsyeshme. Menjëherë pas Mitrovicës, ishte Ferizaj me 73%, Gjlani me 72%, Gjakova me 69% dhe Prishtina me 68%. Peja i ndiqte gjykatat e tjera me vetëm 12% që ishin përgjigjur pozitivisht. Shumica e përdoruesve të shërbimeve në Gjykatën Themelore të Prizrenit (55%) gjithashtu nuk ia kishin dalë të kryenin punë në gjykatë brenda kohës së arsyeshme.

TABELA 4.1: A ISHIT NË GJENDJE QË SOT TË KRYENIT PUNË NË GJYKATË BRENDË KOHËS SË ARSYESHME?

		Po	Jo
	Prishtinë	68.26%	31.74%
	Mitrovicë	75.61%	24.39%
	Pejë	12.11%	87.89%
	Prizren	44.85%	55.15%
	Ferizaj	72.93%	27.07%
	Gjilan	72.26%	27.74%
	Gjakovë	69.23%	30.77%

Pjesëmarrësit e DFG-ve në shumicën e herave u pajtuan me gjetjet e anketës. Një gjë me interes është se përdoruesit e shërbimeve nga Prishtina mendonin se, gjyqtarëve u duhej kohë e gjatë për ta caktuar seancën e parë dëgjimore, e pastaj nguteshin që t'i përfundonin seancat tjera. Përdoruesit e gjykatës nga komuniteti joshumicë nga Mitrovica konstatuan se gjykata ishte shumë efikase, përveç kur mungesa e përkthyesve bënte që palët të prisnin. Pjesëmarrësit nga Peja, Prizreni dhe Ferizaj, shprehën shqetësime për kohën e humbur për shkak të mungesës së qartësisë në procedurat e seancave, mosardhjen e palëve tjera në seanca (ose për t'u ftuar të marrin pjesë) dhe shtyrjeve të shpeshta.

Kur ishin pyetur se që sa kohë kishte mbetur pezull lënda e tyre, të anketuarit kishin mundësinë të zgjedhin midis kohës më pak se gjashtë muaj dhe më shumë se dhjetë vjet, me katër opsioneve të tjera midis këtyre. Në gjykatat themelore të Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjiçanit, numri më i madh i të anketuarve treguan se lënda tyre ishte aktive për më pak se gjashtë muaj. Numri më i madh i të anketuarve në Mitrovicë, Pejë dhe Gjakovë kishin raportuar se lëndët e kishin pezull deri në një vit. Në të gjitha gjykatat përveç në Prishtinë dhe Prizren, shumica e të anketuarve kishin raportuar se lëndët e tyre kishin mbetur pezull deri në një vit. Kështu që shumica e të anketuarve në të gjitha gjykatat raportuan se lëndët e tyre ishin pezull për më pak se dy vjet. Lënda konsiderohet si e vjetër dhe e papërfunduar nëse ka mbetur pezull për më shumë se dy vjet.

TABELA 4.2: SA KOHË KA MBETUR PEZULL LËNDA E JUAJ?

KOMUNITETET JOSHUMICË	Më pak se gjashtë muaj	Deri në një vit	Deri në dy vjet	Më shumë se dy vjet	Më shumë se 5 vjet	Më shumë se 10 vjet
 Prishtinë	25.45%	20.06%	14.07%	18.56%	14.07%	7.78%
 Mitrovicë	24.39%	32.68%	19.02%	15.12%	3.41%	5.37%
 Pejë	5.79%	53.16%	30.53%	10.00%	0.53%	0.00%
 Prizren	29.09%	19.39%	10.30%	20.00%	12.73%	8.48%
 Ferizaj	34.59%	27.07%	17.29%	13.53%	6.02%	1.50%
 Gjilan	33.58%	31.39%	13.14%	8.76%	6.57%	6.57%
 Gjakovë	30.34%	40.00%	15.17%	6.21%	3.45%	4.83%

Siç na tregon Tabela 4.3, shumica e të anketuarve ishin të kënaqur me kohën që ju duhej gjykatave t'i shqyrtojnë lëndët e tyre. Në Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë, shumica kishin raportuar me deri diku të kënaqur ose si shumë të kënaqur (53% në Mitrovicë, 74% në Pejë, 86% në Ferizaj, 55% në Gjilan dhe 62% në Gjakovë). Vetëm Prishtina dhe Prizreni, ku shumica e të anketuarve ishin të pakënaqur (respektivisht 55% dhe 77%) me kohën që i duhej gjykatës. Sidoqoftë, duhet të theksohet se një numër i madh i të anketuarve nga Prishtina (114 nga 334), kishin pretenduar që ishin deri diku të kënaqur me kohën që i duhej gjykatës për të zgjidhur lëndët e tyre.

TABELA 4.3: A JENI I KËNAQUR ME KOHËN BRENDË SË CILËS ËSHTË SHQYRTUAR LËNDA JUAJ?

		Tejet i pa- kënaqur	Deri diku i pa- kënaqur	Deri diku i kë- naqur	Shumë i kë- naqur
	Prishtinë	42.81%	11.98%	34.13%	11.08%
	Mitrovicë	21.95%	24.39%	41.95%	11.71%
	Pejë	11.58%	13.68%	72.63%	2.11%
	Prizren	65.45%	6.06%	19.39%	9.09%
	Ferizaj	6.77%	6.77%	57.89%	28.57%
	Gjilan	36.50%	8.03%	31.39%	24.09%
	Gjakovë	13.99%	23.78%	52.45%	9.79%

Disa nga pjesëmarrësit e DFG-ve pretenduan se lëndët e tyre ishin aktive për më shumë se 20 vjet. Pjesëmarrësit e Gjilanit vunë në pah se tranzicioni i sistemit të drejtësisë dhe reformat që kanë ndodhur përgjatë viteve kanë rezultuar që lëndët e tyre të transferohen nga një gjykatë në tjetrën.

4.2. Trajtimi në gjykatë

Mënyra se si qytetarët trajtohen nga stafi i gjykatës është elementi kryesor që tregon nivelin e profesionalizmit të këtij të fundit. Në këtë rrafsh, gjykatat themelore në shkallë të madhe janë vlerësuar pozitivisht nga përdoruesit e gjykatave. Shumica dërrmuese e të anketuarve (86% ose 1125 nga 1307), si nga komuniteti shumicë ashtu edhe nga ato joshumicë, u përgjigjen pozitivisht në pyetjen nëse ata ishin trajtuar me respekt nga stafi i gjykatës. Gjykata Themelore në Pejë, Ferizaj dhe Prishtinë dalin më mirë në këtë drejtim, ku 90% e të anketuarve kishin pretenduar se ishin trajtuar me mirësjellje nga stafi i gjykatës.

TABELA 4.4.1: A JENI TRAJTUAR ME MIRËSJELLJE DHE RESPEKT NGA STAFI I GJYKATËS?

		Po	Jo	Në njëfarë mase
	Prishtinë	83.83%	6.29%	9.88%
	Mitrovicë	91.71%	0.98%	7.32%
	Pejë	94.74%	1.05%	4.21%
	Prizren	78.18%	6.67%	15.15%
	Ferizaj	92.48%	4.51%	3.01%
	Gjilan	89.05%	6.57%	4.38%
	Gjakovë	72.03%	4.20%	23.78%

Pavarësisht nëse i anketuari ishte burrë apo grua, ndjenja e të gjithë të anketuarve është e njëjtë në të gjitha gjykatat themelore. 87% e burrave dhe 82% e grave ishin përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse ata trajtoheshin me mirësjellje dhe respekt nga stafi i gjykatës, ndërsa 10% e burrave dhe 13% e grave zgjedhën opsionin e përgjigjes deri në njëfarë mase.

TABELA 4.4.2: A JENI TRAJTUAR ME MIRËSJELLJE DHE RESPEKT NGA STAFI I GJYKATËS?

		Po		Jo		Në njëfarë mase	
							
		Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
	Prishtinë	83.21%	16.79%	95.24%	4.76%	84.85%	15.15%
	Mitrovicë	88.30%	11.70%	100.00%	0.00%	100.00%	0.00%
	Pejë	86.11%	13.89%	50.00%	50.00%	50.00%	50.00%
	Prizren	93.02%	6.98%	81.82%	18.18%	92.00%	8.00%
	Ferizaj	91.87%	8.13%	83.33%	16.67%	75.00%	25.00%
	Gjilan	95.90%	4.10%	88.89%	11.11%	100.00%	0.00%
	Gjakovë	81.55%	18.45%	83.33%	16.67%	70.59%	29.41%

Pjesëmarrësit e DFG-ve në masë të madhe u pajtuan me gjetjet e anketës. Ata treguan përvojën e tyre pozitive për trajtim me mirësjellje dhe respekt nga stafi i gjykatës në të shtatë gjykatat themelore. Ata pohuan se personeli i administratës së gjykatave është shumë profesional dhe i trajton me respekt, sa herë që vizitojnë gjykatën.

Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë përcakton rregullat që këta të fundit duhet t'i respektojnë gjatë seancave dëgjimore për të treguar kështu trajtim të barabartë dhe të drejtë për palët në procedurë⁹. Prandaj, të anketuarit ishin pyetur nëse gjatë seancave të tyre dëgjimore ishin trajtuar me drejtësi nga gjyqtari. Shumica e të anketuarve në të gjitha gjykatat themelore, përveç në Prizren, ishin përgjigjur se gjyqtarët i kishin trajtuar drejtë (69% ose 789 nga 1142)¹⁰. 54% të atyre në Prizren deklaruan se nuk ishin trajtuar drejtë nga gjyqtari.

TABELA 4.5: A MENDONI SE JENI TRAJTUAR DREJTË NGA GJYQTARI?

		Po	Jo	Në njëfarë mase
	Prishtinë	70.66%	15.57%	13.77%
	Mitrovicë	58.05%	4.88%	37.07%
	Pejë	72.63%	8.42%	18.95%
	Prizren	35.76%	53.94%	10.30%
	Ferizaj	91.73%	3.76%	4.51%
	Gjilan	78.83%	18.98%	2.19%
	Gjakovë	46.15%	13.29%	40.56%

⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë. E marrë nga <http://bit.ly/2r6wyzR>.

¹⁰ Përgjigjet e mbledhura nga përdoruesit e shërbimeve të ofruara nga Gjykata Themelore e Prizrenit janë përjashtuar nga kjo llogaritje.

Të gjeturat zbulojnë të njëjtën ndjejnë edhe kur ndahen sipas gjinisë, siç pasqyrohet në tabelën 4.6.1 si më poshtë.

TABELA 4.6.1: A MENDONI SE JENI TRAJTUAR DREJTË NGA GJYQTARI?

		Po		Jo		Në njëfarë mase	
							
		Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
	Prishtinë	83.05%	16.95%	84.62%	15.38%	89.13%	10.87%
	Mitrovicë	84.87%	15.13%	80.00%	20.00%	97.37%	2.63%
	Pejë	90.58%	9.42%	68.75%	31.25%	66.67%	33.33%
	Prizren	91.53%	8.47%	92.13%	7.87%	94.12%	5.88%
	Ferizaj	90.98%	9.02%	80.00%	20.00%	100.00%	0.00%
	Gjilan	99.05%	0.95%	88.89%	11.11%	60.00%	40.00%
	Gjakovë	77.14%	22.86%	73.33%	26.67%	82.76%	17.24%

4.3. Përdorimi i gjuhës amtare

Katër pyetjet e mëposhtme ishin shtruar për të mbledhur të dhëna për çështjen e përdorimit të gjuhëve, kryesisht në lidhje me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave nga komunitetet joshumicë. Ligji Nr. 03 / L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 6, paragrafi 6.1 përcakton që, të dy gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë duhet të përdoren në mënyrë të barabartë. Rrjedhimisht, përdoruesit e gjykatës u pyetën nëse kanë qenë në gjendje të komunikojnë me stafin e gjykatës në gjuhën e tyre amtare. Të shtatë gjykatat themelore ishin vlerësuar pozitivisht në këtë drejtim. Siç tregon tabela më poshtë, një pjesë e madhe e të anketuarve nga komunitetet joshumicë (96%, ose 321 nga 333) kishin pranuar se mund të flasin me stafin e gjykatës në gjuhën e tyre amtare.

TABELA 4.7: A KENI QENË NË GJENDJE TË BISEDONI ME STAFIN E GJYKATËS NË GJUHËN TUAJ AMTARE?

		Po	Jo
	Prishtinë	95%	5%
	Mitrovicë	100%	0%
	Pejë	100%	0%
	Prizren	86%	14%
	Ferizaj	100%	0%
	Gjilan	89%	11%
	Gjakovë	100%	0%

Në seancat dëgjimore kur njëra nga palët dhe/ose gjyqtari (ët) i përkasin bashkësive të ndryshme etnike, sigurimi i përkthimit nga gjykatat është i detyrueshëm. Ligji për Procedurën Kontestimore gjithashtu përcakton që palët në procedurë mund të zgjedhin të përdorin ndërmjet gjuhëve zyrtare ose gjuhës që e flasin dhe kuptojnë. Gjetjet në tabelën 4.8 tregojnë se, pothuajse të gjithë përdoruesit e shërbimeve të gjykatës nga komuniteti joshumicë në shtatë gjykatat themelore (91% ose 304 nga 333) kishin treguar se në të vërtetë atyre u ishte siguruar përkthimi gjatë seancave.

TABELA 4.8: A UA KA SIGURUAR GJYKATA PËRTHIMIN GJATË SEANCAVE?

		Po	Jo
	Prishtinë	82.46%	17.54%
	Mitrovicë	98.88%	1.12%
	Pejë	100.00%	0.00%
	Prizren	90.48%	9.52%
	Ferizaj	100.00%	0.00%
	Gjilan	89.29%	10.71%
	Gjakovë	64.52%	35.48%

Gjetjet e studimit tregojnë se gjykatat në masë të madhe e respektojnë Ligjin për Procedurën Kontestimore. Shumica dërrmuese e të anketuarve ishin ose *deri diku të kënaqur* (38%) ose *shumë të kënaqur* (49%) me cilësinë e përkthimit, më gjithë faktin se 38% me deri diku të kënaqur nënkupton që ka hapësirë për përmirësim.

TABELA 4.9: A ISHIT TË KËNAQUR ME CILËSINË E PËRKTHIMIT GJATË SEANCEVE?

		Tejet i pakënaqur	Deri diku i pakënaqur	Deri diku i kënaqur	Shumë i kënaqur
	Prishtinë	0.00%	4.26%	51.06%	44.68%
	Mitrovicë	0.00%	3.41%	52.27%	44.32%
	Pejë	0.00%	3.90%	49.35%	46.75%
	Prizren	5.26%	0.00%	39.47%	55.26%
	Ferizaj	11.11%	0.00%	22.22%	66.67%
	Gjilan	4.00%	0.00%	12.00%	84.00%
	Gjakovë	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%

Pjesëmarrësit e DFG-së në Mitrovicë si nga komuniteti shumicë dhe ai joshumicë i konfirmuan gjetjet e anketës, ku treguan se gjithashtu ishin shumë të kënaqur me cilësinë e përkthimit.

Informacioni që ofrohet nga gjykatat themelore nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Tabela më poshtë tregon se, përveç në Prizren, një shumicë e konsiderueshme e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës në secilën nga gjykatat themelore i kishin marrë dokumentet gjyqësore në gjuhën e tyre amtare.

TABELA 4.10: A I MORËT DOKUMENTET E GJYKATËS NË GJUHËN TUAJ AMTARE?

		Po	Jo	Nganjëherë
	Prishtinë	54.39%	8.77%	36.84%
	Mitrovicë	89.89%	3.37%	6.74%
	Pejë	90.91%	1.30%	7.79%
	Prizren	35.71%	64.29%	0.00%
	Ferizaj	88.89%	11.11%	0.00%
	Gjilan	75.00%	21.43%	3.57%
	Gjakovë	100.00%	0.00%	0.00%

Dy pyetjet e mëposhtme paraqesin gjetjet e bashkuara nga përgjigjet e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nga komuniteti shumicë dhe joshumicë. Kjo është bërë për dy arsye: a) ata përqendrohen në çështje që bashkërisht i preokupojnë dhe b) nuk ka dallime në përvorjat ndërmjet përdoruesve të shërbimeve të gjykatave nga komuniteti shumicë dhe joshumicë. Rezultatet e anketës tregojnë se shumica mbizotëruese e përdoruesve të shërbimeve të gjykatave në të gjitha gjykatat dhe nga të gjitha komunitetet, ndjehen fizikisht të sigurt në ambientet e gjykatës, me 97% (1270 nga 1307) të të anketuarve që u përgjigjën pozitivisht.

TABELA 4.11: A NDIHENI I SIGURT (FIZIKISHT) NË AMBIENTET E GJYKATËS?

		Po	Jo
	Prishtinë	99.70%	0.30%
	Mitrovicë	98.05%	1.95%
	Pejë	98.95%	1.05%
	Prizren	89.70%	10.30%
	Ferizaj	97.74%	2.26%
	Gjilan	95.62%	4.38%
	Gjakovë	97.20%	2.80%

Kjo pyetje ishte pasuar nga një pyetje e hapur, që synon të zbulojë arsyet pse palët nuk ndjeheshin të sigurt në objektet e gjykatës. Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje që dallojnë nga mungesa e besimit në gjyqësor deri te kërcënimet e përjetuara në sallën e gjyqit.

NËSE JO, PSE NUK NDJEHENI TË SIGURT NË AMBIENTET E GJYKATËS?

Numri i përgjigjeve	Llojet e përgjigjeve
 3	Mungesa e besimit në sistemin gjyqësor
 2	Mungesa e sigurisë, çdokush sipas dëshirës mund të hynte në ambientet e gjykatës
 2	Një i anketuar pretendonte të ishte kërcënuar, një tjetër pretendonte të ishte shtyrë gjersa ishte në ambientet e gjykatës

Në DFG-të në Pejë dhe Gjiilan disa gra pretendonin se nuk ndiheshin të sigurt në ambientet e gjykatës pasi që ishin kërcënuar nga pala tjetër dhe vazhdimisht kishin pasur frikë nga sulmi i mundshëm fizik.

Pala në procedurë gëzon të drejtën të ushtrojë ankesë disiplinore kundër gjyqtarit për sjelljen e tij të pahijshme. Ishte përfshirë edhe një pyetje për të vlerësuar nëse përdoruesit e gjykatës janë të vetëdijshëm për këtë të drejtë. Shumica (61% ose 809 nga 1307) nuk kishin qenë të vetëdijshëm për këtë mundësi. Vetëm në Gjakovë, një pjesë e madhe e të anketuarve (60%) kishin pretenduar se ishin të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për të ushtruar këtë lloj ankese.

TABELA 4.12: A E DINI SE MUND TË USHTRONI ANKESË KUNDËR GJYQTARIT PËR SHKELJE DISIPLINORE?

		Po	Jo
	Prishtinë	32.93%	67.07%
	Mitrovicë	36.59%	63.41%
	Pejë	43.68%	56.32%
	Prizren	43.03%	56.97%
	Ferizaj	19.55%	80.45%
	Gjilan	33.58%	66.42%
	Gjakovë	60.84%	39.16%

Kjo pyetje ishte pasuar nga një nënpyetje e hapur, me synimin të identifikojë, nëse ata që pretendonin se ishin të vetëdijshëm për këtë mundësi, a e dinin edhe se ku mund t'i ushtronin ankesat e tilla. Ata që pretendonin se kishin njohuri për këtë mundësi shpreheshin se, ishin informuar se mund të ushtronin ankesë për shkelje disiplinore nga gjyqtari. Përgjigjet ndryshojnë nga gjykatat themelore të gjykata e shkallës së dytë, siç është Gjykata e Apelit.

A E DINI SE KU DUHET TË USHTRONI ANKESË?

Numri i përgjigjeve	Paraqitja e ankesës
 54	Të anketuarit thanë se mund të ushtrojnë padi në gjykatën themelore
 10	Në Komisionin Disiplinor
 10	Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës
 6	Gjykatën e Apelit ose departamentin e ankesave brenda vetë gjykatës

FDG-të vërtetuan se në shkallë të madhe, përdoruesit e gjykatës nuk ishin të informuar në lidhje me të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë kundër gjyqtarëve për shkelje disiplinore. Shumica dërmuese e pjesëmarrësve të DFG-ve gjithashtu kishin besimin se edhe nëse do të ushtronin një ankesë të tillë, nuk do të merrej ndonjë veprim kundër gjyqtarit.


4.4. Rangimi i përgjithshëm i efikasitetit dhe paanësisë

Gjykatat themelore janë renditur si më poshtë, sipas nivelit të tyre të efikasitetit dhe trajtimit të drejtë bazuar në përvojat e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës që kanë raste të lëna pezull, ku 1 qëndron më mirë në krahasim me gjykatat e tjera, dhe 7 është më dobët në krahasim me gjykatat e tjera. Rezultatet për secilën gjykatë janë llogaritur duke përdorur pikët mesatare të nxjerra nga numri i përgjigjeve pozitive ose negative që të anketuarit kanë dhënë në pyetjet më poshtë ¹¹. Rezultatet e anketës tregojnë se Gjykata Themelore e Pejës renditet relativisht më mirë se pjesa tjetër e gjykatave themelore.

11 Sa më shumë përgjigje pozitive në secilën pyetje që ka marrë gjykata, aq më shumë pikë ka mbledhur: Gjykata Themelore e Prishtinës (21.62 pikë), Prizreni (22.3 pikë), Gjakova (23.11 pikë), Gjilan (23.18 pikë), Ferizaj (23.71 pikë) Mitrovica (25.40 pikë), Pejë (25.47 pikë)

1. A ishit në gjendje që sot të kryenit punën tuaj në gjykatë në kohë të arsyeshme? 2. Sa kohë ka lënda e juaj që ka mbetur pezull ? 3. A jeni i kënaqur me kohën brenda së cilës është shqyrtuar çështja juaj? 4. A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt nga stafi i gjykatës? 5. A mendoni se jeni trajtuar me drejtësi nga gjyqtari? 6. A keni qenë në gjendje të bisedoni me stafin e gjykatës në gjuhën tuaj amtare? 7. A ishit të kënaqur me cilësinë e përkthimit gjatë seancave? 8. A i morët dokumentet gjyqësore në gjuhën tuaj amtare? 9. A ndiheni i sigurt (fizikisht) në ambientet e gjykatës? 10. A e dini se mund të ushtroni padi për shkelje disiplinore të gjyqtarit.

TABELA 4.13: RANGIMI I GJYKATAVE THEMELORE PËR EFIKASITET



“

Shumica e përdoruesve pohuan se korrupsioni nuk është problematikë në gjykatat e Kosovës.

5. PREVALENCA E KORRUPSIONIT

Kjo pjesë analizon përvojën e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës lidhur me korrupsionin, konkretisht nëse atyre u është kërkuar ose ofruar ryshfet, dhe nëse po, për çfarë arsye (-esh). Kjo pyetje ishte pasuar nga një nënpyetje për pozitën që mban personi që ka kërkuar ose ka pranuar ryshfet në gjykatën përkatëse.

5.1. Ryshfeti

Përdoruesit e gjykatës ishin pyetur nëse u ishte kërkuar ryshfet nga ndonjë punonjës i gjykatës, përfshirë gjyqtarë, ose ndonjë ndërmjetës që vepron në emër të një punonjësi të gjykatës. Rezultatet e dhëna në tabelën më poshtë tregojnë se, në shkallë të madhe, përdoruesit e gjykatës pretendonin se nuk u ishte kërkuar ryshfet. Në të vërtetë, në tri gjykata, të gjithë të anketuarit kësaj pyetje i ishin përgjigjur me Jo. Në tri gjykata tjera, ata që ishin përgjigjur me Po i ishin më pak se 2%. Vetëm në Prizren, kishin dhënë përgjigje pozitive duke tejkaluar 12%.

TABELA 5.1: A U ËSHTË KËRKUAR NDONJËHERË RYSHFET NGA GJYQTARI OSE PUNONJËSI I GJYKATËS OSE NGA NJË NDËRMJETËS QË VEPRON NË EMËR TË KËTIJ TË FUNDIT?

		Po	Jo
	Prishtinë	1.80%	98.20%
	Mitrovicë	0.00%	100 %
	Pejë	0.53%	99.47%
	Prizren	12.12%	87.88%
	Ferizaj	0.00%	100%
	Gjilan	1.46%	98.54%
	Gjakovë	0.00%	100%

Ata që u përgjigjën pozitivisht ishin pyetur për arsyen pse u ishte kërkuar të jepnin ryshfet dhe u ishin ofruan tri mundësi si në vijim:

TABELA 5.2: NËSE PO, ATËHERË PËR ÇFARË ARSYE?

		Për përshpejtim të procedurës	Për të marrë doku- mentacionin e nevo- jshëm	Që lënda të vendoset në favorin tim
	Prishtinë	3	1	4
	Mitrovicë	0	0	0
	Pejë	1	0	0
	Prizren	13	2	10
	Ferizaj	0	0	0
	Gjilan	2	0	1
	Gjakovë	0	0	0

Shënim: Të dhënat janë paraqitur në shifra për shkak të numrit të vogël të anketuarve që ju kanë përgjigjur kësaj pyetjeje pasuese.

Të anketuarit më pas u pyetën nëse mund të identifikojnë pozitën që mban personi i cili u kërkoi ryshfet? Shumica treguan se ishte punonjës i *gjykatës*, ndërsa shtatë të anketuar në Prizren dhe dy në Gjilan pretenduan se ishte vetë gjyqtari i cili u kërkoi ryshfet.

TABELA 5.3: NËSE PO, ÇFARË POZITE MBANTE PERSONI?

		Gjyqtar	Punonjës i gjykatës	Të tjerë
	Prishtinë	0	2	0
	Mitrovicë	0	0	0
	Pejë	0	1	0
	Prizren	7	13	0
	Ferizaj	0	0	0
	Gjilan	2	0	0
	Gjakovë	0	0	0

Shënim: Të dhënat janë paraqitur në shifra për shkak të numrit të vogël të anketuarve që ju kanë përgjigjur kësaj pyetjeje pasuese.

Të anketuarit gjithashtu janë pyetur nëse i kanë ofruar ryshfet ndonjë gjyqtari ose punonjësi të gjykatës. Shumica e të anketuarve pretenduan të mos kenë ofruar ndonjëherë ryshfete, megjithëse disa pranuan ta kenë bërë këtë, në Prizren (6), Mitrovicë (4), Pejë (2) dhe Gjilan (1).

TABELA 5.4: A I KENI OFRUAR NDONJËHERË RYSHFET NDONJË GJYQTARI OSE PUNONJËSI TË GJYKATËS?

		Po	Jo
	Prishtinë	0.00%	100%
	Mitrovicë	1.95%	98.05%
	Pejë	1.05%	98.95%
	Prizren	4.24%	95.76%
	Ferizaj	0.00%	100 %
	Gjilan	0.73%	99.27%
	Gjakovë	0.00%	100%

Ata që pretenduan se kishin ofruar rryshfet, e kishin bërë këtë në mënyrë që të përshpejtonin procedurën ose që lënda të vendosej në favor të tyre.

TABELA 5.5: NËSE PO, ATËHERË PËR ÇFARË ARSYE?

		Për përshpejtim të procedurës	Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm	Që lënda të vendoset në favorin tim
	Prishtinë	0	0	0
	Mitrovicë	3	0	1
	Pejë	1	0	0
	Prizren	5	0	2
	Ferizaj	0	0	0
	Gjilan	0	1	0
	Gjakovë	0	0	0

Shënim: Të dhënat janë paraqitur në shifra për shkak të numrit të vogël të anketuarve që ju kanë përgjigjur kësaj pyetjeje pasuese.

Kur të anketuarit e njëjtë u pyetën me nënpyetje të dytë në lidhje me pozitën e personit të cilit i kishin ofruar ryshfet, ata u përgjigjën ose gjyqtar ose punonjës i gjykatës.

TABELA 5.6: NËSE PO, ÇFARË POZITE MBANTE PERSONI?

		Gjyqtar	Punonjës i gjykatës	Të tjerë
	Prishtinë	0	0	0
	Mitrovicë	0	4	0
	Pejë	0	1	0
	Prizren	2	5	0
	Ferizaj	0	0	0
	Gjilan	1	0	0
	Gjakovë	0	0	0

Shënim: Të dhënat janë paraqitur në shifra për shkak të numrit të vogël të anketuarve që ju kanë përgjigjur kësaj pyetjeje pasuese.

Çështja e korrupsionit ishte trajtuar edhe në DFG. Pjesëmarrësit në të gjitha DFG-të shprehen mendimet e tyre se derisa ryshfeti si metodë e korrupsionit nuk po përdoret më, mjete të tjera, si: ndikimi politik dhe ekonomik ose shkëmbimi i favoreve (siç është punësimi i anëtarëve të familjes në sektorin publik) janë mënyra të zakonshme në të cilat korrupsioni po merr formë.


5.2. Renditja e përgjithshme e gjykatave për prevalencën e korrupsionit

Gjykatat themelore ishin renditur në rrafshin e prevalencës së korrupsionit, bazuar në përvojat e përdoruesve të shërbimeve të gjykatës me raste pezull në gjykatën përkatëse, ku 1 është relativisht më mirë se gjykatat e tjera, ndërsa 7 është relativisht më dobët se gjykatat e tjera. Rezultatet për secilën gjykatë, ishin llogaritur duke përdorur pikët mesatare të nxjerra nga numri i përgjigjeve pozitive ose negative, e që të anketuarit i kanë dhënë në pyetjet si më poshtë¹². Rezultatet e anketës tregojnë se Gjykata Themelore e Ferizajt dhe ajo e Gjakovës renditen relativisht më mirë sesa pjesa tjetër e gjykatave themelore.

1. A ju është kërkuar ndonjëherë ryshfet nga gjyqtari ose punonjësi i gjykatës apo një ndërmjetës që vepron në emër të këtyre si më lartë?

2. A i keni ofruar ryshfet ndonjë gjyqtari ose punonjësi të gjykatës?

TABELA 5.7: RANGIMI I GJYKATAVE THEMELORE



12 Sa më shumë përgjigje pozitive në secilën pyetje që ka marrë gjykata, aq më shumë pikë ka mbledhur, aq më e ulët është renditur ajo gjykatë: Gjykata Themelore e Ferizajt (2 pikë), Gjakova (2 pikë), Peja (2.005), Prishtina (2.017), Mitrovica (2.019), Gjilan (2.02), Prizren (2.16).

13 Për shkak të përgjigjeve në pyetjet për korrupsionin, kur renditja është kryer me metodën e llogaritjes, ku është përfshirë parimi i përfaqësimit proporcional për të dale me një renditje të paanshme. Kështu, përkundër numrit më të lartë të përgjigjeve lidhur me korrupsionin dhënë nga të anketuarit në Prishtinë, Gjykata Themelore e Prishtinës renditet më mirë sesa d.m.th. Gjykata Themelore e Mitrovicës. Ndërsa, Gjykata Themelore e Gjakovës dhe Ferizajt renditen të dy nën 1 sepse të anketuarit nuk raportuan fare korrupsion.

6. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, rekomandimet e dhëna më poshtë janë zhvilluar nga hulumtuesit e D+ dhe ACDC si përgjigje e drejtpërdrejtë në çështjet e identifikuar në studim, si dhe praktikave të mira që do të rezultojnë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit në gjykata. Rekomandimet janë grupuar në fushat e mëposhtme: qasja në informacion; efikasiteti dhe trajtimi i drejtë; prevalenca e korrupsionit.

Qasja në informacion

- Gjykatat themelore duhet të sigurojnë broshura me informacion të përgjithshëm për përdoruesit e shërbimeve të saja. Broshurat duhet të përmbajnë udhëzime të thjeshta se për cilat lloje të informacionit qytetarët kanë të drejtë të i marrin nga gjykata dhe cilat kanale të komunikimit duhet ndjekur. Broshurat duhet të jetë në dispozicion edhe në formë elektronike.
- Të gjitha gjykatat themelore duhet të organizojnë aktivitete promovuese për të informuar qytetarët për përmbajtjen në ueb-faqet e gjykatave dhe mënyrat si të orientohen në to. Në hapësirat e gjykatës mund të vendosen kodet që mund të skanohen përmes pajisjeve mobile që lidhin drejtpërdrejt qytetarët me faqen në internet.
- KGJK-ja duhet të përgatisë një fjalor me përkthime të standardizuara të termave juridikë në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë për të përmirësuar cilësinë e përkthimit.
- Të gjitha gjykatat themelore duhet të krijojnë një sistem të standardizuar të njoftimeve dhe të sigurojnë që të gjitha dokumentet t'u dërgohen me kohë palëve dhe përfaqësuesve / avokatëve të tyre të autorizuar.
- Të gjitha gjykatat themelore duhet të përmirësojnë cilësinë e përkthimit të përmbajtjes në ueb-faqet e tyre.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

- Gjykatat themelore duhet që përdoruesve të shërbimeve të gjykatës të u ofrojë mundësinë që punët në gjykatë t'i kryejnë në mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë, duke thjeshtuar procedurat dhe duke krijuar një sistem të ofrimit të shërbimeve me klientin në qendër.
- Gjykatat themelore duhet të përgatiten më mirë para zhvillimit të seancave, duke përfshirë dërgimin e ftesës me kohë të të gjitha palët e përfshira në procedurë, duke siguruar praninë e përkthyesve (kur është e nevojshme) dhe duke filluar seancën në orarin e paracaktuar.
- Gjykatat themelore duhet të përqendrohen në zgjidhjen e lëndëve që janë më të vjetra se 10 vjet me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve të qytetarëve dhe marrjen e vendikimit final derisa është ende me rëndësi për palët.
- Gjykatat themelore duhet të sigurojnë që gjyqtarët t'i trajtojnë të gjitha palët në mënyrë të barabartë dhe të mos ketë trajtim diskriminues ndaj grave ose komuniteteve joshumicë.
- Gjykatat themelore duhet të respektojnë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe gjithashtu të rrisin cilësinë e përkthimit të njëkohshëm gjatë seancave dëgjimore.
- Gjykatat duhet të përpilojnë broshura për të drejtat e qytetarëve për qasje në informacion, në të cilat gjithashtu duhet të përfshihen informacione rreth të drejtës për të ushtruar ankesë ndaj gjyqtarëve.

Prevalenca e korrupsionit

- Gjykatat themelore duhet të vendosin kontrolle për ryshfet dhe të marrin masa për të parandaluar paraqitjen e korrupsionit, përfshirë trajnime të detyrueshme për zhvillim profesional dhe etikën e gjyqtarëve dhe stafit të gjykatave.
- Gjykatat duhet të miratojnë masa të rrepta mbikëqyrjeje për gjyqtarët dhe punonjësit e tyre, për të siguruar që korrupsioni nuk është iniciuar nga stafi i gjykatës.
- Gjykatat themelore duhet të përfshijnë qytetarët (përdoruesit e gjykatës) që të bëhen pjesë e luftës kundër korrupsionit dhe atë përmes:

- o Krijimit të mekanizmave të sigurt për raportim anonim (numrat për thirrje pa pagesë dhe kuti të ankesave);
- o Informimit të qytetarëve për ekzistencën e tyre (përmes mbulimit në media dhe duke siguruar pllakate dhe broshura informuese);
- o Të vepruarit pas raporteve të korrupsionit, për të inkurajuar dëshmitarë dhe viktime të korrupsionit të ngrijnë zërin dhe të flasin për të.
- Institucionet e drejtësisë duhet të marrin masa për të parandaluar korrupsionin duke iu bërë verifikimin gjyqtarëve.

7. REKOMANDIME KONKRETE PËR SECILËN GJYKATË THEMELORE

Gjykata Themelore në Prishtinë

Qasja në informacion

Përdoruesit e gjykatës pretendojnë se është lehtë të kesh qasje në informacion, por ata ankohen për cilësinë dhe qartësisë e përmbajtjes së dokumenteve që marrin nga gjykata. Prandaj Gjykata Themelore e Prishtinës duhet të sigurojë dokumente që shkruhen në një gjuhë më të kuptueshme që u shërben të gjithë përdoruesve të shërbimeve të gjykatës pavarësisht nga niveli i njohurive të tyre për termat juridikë.

Kjo gjykatë gjithashtu duhet të vendosë kutitë e ankesave dhe t'i bind përdoruesit e shërbimeve të saj që t'i shfrytëzojnë ato dhe t'i sigurojnë se të njëjtat do të shqyrtohen.

Duhet të përmirësojë cilësinë e përkthimit të përmbajtjes së saj në internet dhe ta promovojë atë si burim informacioni të besueshëm dhe të përshtatshëm.

Ueb-faqja e kësaj gjykate duhet të përmbajë informacione të rëndësishme siç janë orari i seancave, informacioni për kontakte dhe vendimet e publikuara dhe të vendosen në një vend ku gjenden me lehtësi.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Gjykata duhet të caktojë një grup pune me një mision të veçantë për të zgjidhur lëndët që kanë mbetur të papërfunduara për më shumë se 10 vjet.

Gjykata duhet t'i informojë shfrytëzuesit e saj në lidhje me të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime kur këta të fundit të shpallen fajtorë, kjo për të rritur besimin e qytetarëve në këtë institucion.

Prevalenca e korrupsionit

Një pjesë e vogël e të anketuarve pretenduan se u ishte kërkuar ryshfet nga punonjësit e gjykatës në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Andaj, personat kompetent duhet t'i ndërmarrin masat përkatëse kundër korrupsionit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Qasja në informacion

Përdoruesit e gjykatës nga komuniteti shumicë pohojnë se kanë lehtësi në qasjen në informacion, por ankohen për cilësinë e përkthimit. Prandaj, Gjykata Themelore e Mitrovicës duhet të përmirësojë cilësinë e përkthimit të dokumenteve.

Kjo gjykatë duhet të vendosë kutitë për ankesa, të promovojë përdorimin e tyre dhe t'i sigurojë përdoruesit e gjykatës që ankesat e tyre do të merren në konsideratë.

Duhet të përmirësojë cilësinë e materialit të përkthyer (gjithashtu të ofrojë trajnime të specializuara për përkthyesit lidhur me termat juridikë) dhe të promovojë faqen e saj të internetit, si një burim i besueshëm informacioni. Për më tepër, ueb-faqja e saj duhet të përmbajë informacione të rëndësishme siç janë orari i seancave dëgjimore, informacione për kontakte dhe vendimet e publikuara të gjendjet lehtësisht.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Gjykata duhet të caktojë një grup pune me një mision të veçantë për zgjidhje të lëndëve që kanë mbetur të pazgjidhura për më shumë se 10 vjet.

Gjykata duhet të informojë përdoruesit e saj në lidhje me të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime kur këta të fundit shpallen fajtorë, me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në këtë institucion.

Prevalenca e korrupsionit

Një pjesë e vogël e të anketuarve pretenduan se i kishin ofruar ryshfet administratës gjyqësore dhe gjyqtarëve në përpjekje për të përshpejtuar procedurat e tyre ose që të vendosin në favor të tyre, kështu që gjykata duhet të ndërmerr masa kundër korrupsionit.

Gjykata Themelore në Pejë

Qasja në informacion

Qytetarët me lëndë të hapura duhet të jenë në gjendje të marrin informacionin e kërkuar nga gjykata pa pasur nevojë të angazhojnë avokat.

Kjo gjykatë duhet të vendosë kutitë për ankesa, të promovojë përdorimin e tyre dhe t'i sigurojë përdoruesit e gjykatës që ankesat e tyre do të merren në konsideratë.

Duhet ta promovojë ueb-faqen si burim informacioni të besueshëm dhe të përshtatshëm për përdoruesit e gjykatës. Për më tepër, faqja e saj në internet duhet të përmbajë informacione të rëndësishme siç janë orari i seancave dëgjimore, informacione rreth kontakteve dhe vendimet e publikuara të jenë në vende ku gjinden më së lehti.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Veprimtaria ditore e gjykatës ka nevojë për përmirësime, në mënyrë që përdoruesit e shërbimeve të jenë në gjendje të kryejnë punë në gjykatë brenda kohës së arsyeshme.

Kjo gjykatë duhet të hartojë rregulla të qarta për seancat dëgjimore dhe të trajnojë stafin e gjykatës për zbatimin e tyre, me qëllim të ruajtjes së kohës së ditës kur mbahen seancat.

Gjykata duhet të caktojë një grup pune me një mision të veçantë për të zgjidhur lëndët që ende nuk janë zgjidhur, e atë për më shumë se 10 vjet.

Menaxhmenti i gjykatës duhet të sigurojë një zbatim më të rreptë të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarët, kështu që përdoruesit e gjykatës të trajtohen profesionalisht pavarësisht nga lloji i lëndës ose gjinisë së tyre.

Për më tepër, kjo gjykatë duhet të përmirësojë masat e saja të sigurisë në mënyrë që gratë përdoruese të shërbimeve të gjykatës të ndjehen të sigurta në ambientet e gjykatës kur marrin pjesë në seancë dëgjimore.

Gjykata duhet t'i informojë përdoruesit e shërbimeve të saja lidhur me të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime në rastet që vërtetohen pretendimet. Në këtë mënyrë do të rritej besimi i qytetarëve në këtë institucion.

Prevalenca e korrupsionit

Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve pohuan të u kenë ofruar ryshfet punonjësve të gjykatës. Megjithatë, gjykata duhet të marrë masa kundër korrupsionit

Gjykata Themelore në Gjakovë

Qasja në informacion

Qytetarët me lëndë të hapura duhet të jenë në gjendje të marrin informacionin e kërkuar nga gjykata, pa pasur nevojë të angazhojnë avokat.

Kjo gjykatë duhet të përmirësojë punën e tavolinës së informacionit dhe të sigurojë që gjithmonë është dikush që t'i informojë dhe orientojë përdoruesit e gjykatës.

Duhet të promovojë ueb-faqen e saj si burim informacioni i besueshëm dhe i përshtatshëm për përdoruesit e gjykatës. Për më tepër, faja e saj në internet duhet të përmbajë informacione të rëndësishme, siç janë orari i seancave dëgjimore, informacione për kontakte dhe vendimet e publikuara të gjenden lehtësisht.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Gjykata duhet të caktojë një grup pune me një mision të veçantë për të zgjidhur lëndët që kanë qenë të hapura për më shumë se 10 vjet.

Menaxhmenti i Gjykatës Themelore të Gjakovës duhet të sigurojë zbatim më të rreptë të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarët, kështu që përdoruesit e gjykatës të trajtohen me profesionalizëm.

Gjykata duhet t'i informojë përdoruesit e shërbimeve të saja lidhur me të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime kur të njëjtit shpallen fajtorë, me ç'rast do të rritet besimi i qytetarëve në këtë institucion.

Gjykata Themelore në Gjilan

Qasja në informacion

Qytetarët me lëndë të hapura duhet të jenë në gjendje të marrin informacionin e kërkuar nga gjykata pa pasur nevojë të angazhojnë avokat. Për më tepër, shfrytëzuesit e gjykatës duhet të kenë mundësinë për të marrë informacion nga distanca, pa qenë e nevojshme ta vizitojnë fizikisht godinën e gjykatës.

Kjo gjykatë duhet të vendosë kutitë për ankesa, të promovojë përdorimin e tyre dhe t'i sigurojë përdoruesit e gjykatës që ankesat e tyre do të merren në konsideratë.

Të përmirësojë punën e tavolinës së informacionit dhe të sigurohet që shërbyesi është gjithmonë aty për të informuar dhe orientuar shfrytëzuesit shërbimeve të gjykatës.

Duhet të promovojë faqen e internetit të saj si burim informacioni të besueshëm dhe të përshtatshëm për përdoruesit e gjykatës. Për më tepër, ueb-faqja e saj duhet të përmbajë informacione të rëndësishme siç janë orari i seancave dëgjimore, informacione për kontaktim dhe vendimet e publikuara të gjenden lehtësisht.

Renditur në vendin e tretë nga shtatë gjykatat themelore në lidhje me qasjen në informacion, Gjykata Themelore e Gjilanit duhet të shikojë përtej këtyre rekomandimeve për t'u ngjitur në listën e rangimit.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Gjykata duhet të caktojë një grup pune me një mision të veçantë për të zgjidhur lëndët që kanë qenë të hapura për më shumë se 10 vjet.

Menaxhmenti i gjykatës duhet të sigurojë një zbatim më të rreptë të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarët, kështu që përdoruesit e gjykatës të trajtohen profesionalisht pavarësisht nga lloji i lëndës ose gjinisë së tyre.

Masat e sigurisë duhet të përmirësohen në mënyrë që gratë përdoruese të shërbimeve të gjykatës të ndjehen të sigurta në gjykatë kur marrin pjesë në seanca dëgjimore.

Gjykata duhet t'i informojë përdoruesit e shërbimeve të saja lidhur me të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime në rast kur vërtetohen pretendimet, kjo gjë do të rriste besimin e qytetarëve në këtë institucion.

Duke u renditur në mes të tabelës së renditjes sa i përket efikasitetit dhe trajtimit të drejtë, Gjykata Themelore e Gjilanit duhet të përmirësojë edhe më shumë punën e mirë në mënyrë që të ngjitet në vende më të larta në listën e rangimit.

Prevalenca e korrupsionit

Një pjesë e vogël e të anketuarve pretendojnë se u është kërkuar ryshfet në Gjykatën Themelore të Gjilanit, prandaj menaxhmenti duhet të zbatojë një politikë rigoroze kundër korrupsionit.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Qasja në informacion

Qytetarët me lëndë të hapura duhet të jenë në gjendje të marrin informacionin e kërkuar nga gjykata pa pasur nevojë të angazhojnë avokat.

Kjo gjykatë duhet të vendosë kutitë për ankesa, të promovojë përdorimin e tyre dhe t'i sigurojë përdoruesit e gjykatës që ankesat e tyre do të merren në konsideratë.

Duhet të promovojë faqen e saj të internetit si burim informacioni të besueshëm dhe të përshtatshëm për përdoruesit e gjykatës. Për më tepër, ueb-faqja e saj duhet të përmbajë informacione të rëndësishme siç janë orari i seancave dëgjimore, informacione për kontaktim dhe vendimet të publikohen në një vend ku mund të gjenden lehtësisht.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Përdoruesit e gjykatës pranojnë se seancat shtyhen ose anulohen shumë shpesh, kështu që gjykata duhet t'i merr të gjitha masat e nevojshme para seancës dëgjimore për të zvogëluar shtyrjet ose anulimet.

Gjykata duhet të caktojë një grup punues me mision të veçantë për të zgjidhur lëndët që janë të hapura për më shumë se 10 vjet.

Gjykata duhet t'i informojë përdoruesit e shërbimeve të saj lidhur me të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime kur këta të fundit shpallen fajtorë. Me këtë do të rritet besimi i qytetarëve në këtë institucion.

Gjykata Themelore në Prizren

Qasja në informacion

Qytetarët me lëndë të hapura duhet të jenë në gjendje të marrin informacionin e kërkuar nga gjykata pa pasur nevojë të angazhojnë avokat.

Kjo gjykatë duhet të vendosë kutitë për ankesa, të promovojë përdorimin e tyre dhe t'i sigurojë përdoruesit e gjykatës që ankesat e tyre do të merren në konsideratë.

Duhet të promovojë faqen e internetit të saj si burim informacioni të besueshëm dhe të përshtatshëm për përdoruesit e gjykatës. Për më tepër, ueb-faqja e saj duhet të përmbajë informacione të rëndësishme siç janë orari i seancave dëgjimore, informacione për kontaktim dhe vendimet e publikuara të gjenden lehtësisht.

Efikasiteti dhe Trajtimi i Drejtë

Operacionet e përditshme të gjykatës kanë nevojë për përmirësime në mënyrë që përdoruesit e shërbimeve të jenë në gjendje që punët e tyre në gjykatë t'i kryejnë brenda një kohe të arsyeshme.

Gjykata duhet të marrë masa për t'u përgatitur për seanca, d.m.th. të zvogëlojë numrin e rasteve kur seancat dëgjimore caktohen pa u ftuar të gjitha palët.

Gjykata duhet të caktojë një grup pune me mision të veçantë, për të zgjidhur lëndët që janë të papërfunduara për më shumë se 10 vjet.

Menaxhmenti i Gjykatës Themelore të Prizrenit duhet të sigurojë një zbatim më të rreptë të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarët, kështu që përdoruesit e gjykatës të trajtohen profesionalisht pavarësisht nga lloji i lëndës ose gjinisë së tyre.

Gjykata Themelore e Prizrenit, duhet të përmirësohet në dorëzimin e dokumenteve edhe në dy gjuhët tjera zyrtare, përveç asaj shqipe.

Gjykata duhet t'i informojë përdoruesit e shërbimeve lidhur me të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe të zbatojë dënime kur këta të fundit shpallen fajtorë, kjo gjë do të rriste besimin e qytetarëve në këtë institucion.

Prevalenca e korrupsionit

Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve pretendojnë se u është kërkuar ryshfet në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Prandaj, menaxhmenti duhet të ndërmerr masa kundër korrupsionit.

SHTOJCA

D+ dhe ACDC - Pyetësi i Përdoruesve të Gjykatës Transparenca / Qasja dhe Efikasiteti i Gjykatave Themelore në Kosovë

UDHËZIM: Jashtë gjykatore, numëruesi i terrenit i afrohet çdo personi të n-të që del nga gjykata ku ka qenë për të mbaruar punë, si dhe vijon:

Përshëndetje, unë jam _____. Punoj si intervistues/e për organizatën Demokraci Plus, nën-kontraktues i Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP). Jemi duke bërë një anketë për të kuptuar se çfarë mendojnë qytetarët për efikasitetin dhe nivelin e transparencës së Gjykatave Themelore. A do të na falnit disa minuta për t'u përgjigjur në disa pyetje? Anketa është anonime dhe të gjitha të dhënat do të paraqiten si të dhëna grupore të cilat do të përdoren vetëm për qëllimet e këtij projekti.

DATA E INTERVISTËS

KOHA E INTERVISTËS

NUMRI I INTERVISTËS

NGA _____

REGJIONI



1. PRISHTINA
2. MITROVICA
3. PEJA
4. GJAKOVA
5. GJILAN
6. FERIZAJ
7. PRIZREN

GJINIA E RESPONENTIT



1. MASHKULL
2. FEMËR

MOSHA E RESPONENTIT

1. 18 – 24 VJEÇ
2. 25 – 34 VJEÇ
3. 35 – 44 VJEÇ
4. 45 – 54 VJEÇ
5. 55 – 64 VJEÇ
6. 65+ VJEÇ

PËRKATËSIA ETNIKE E RESPONENTIT



1. Shqiptar
 2. Serb
 3. Turk
 4. Boshnjak
 5. Rom
 6. Ashkali
 7. Egjiptas
 8. Goran
 9. Tjetër
-

Arsyeja pse respondentit ka ardhur në gjykatë

P.1 Pse keni ardhur sot në gjykatë?

Nëse janë kodet 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 apo 10 MOS VAZHDO me pyetësin.

1. Palë në procedurë – person fizik

☐ PADITËS

☐ I PADITUR

☐ I PANDEHUR APO AKUZUAR

☐ VIKTIMË

1a. Çfarë lloji rasti ju ka sjellë në gjykatë?

☐ Penal

☐ Civil

☐ Ekonomik

☐ Administrativ

☐ Kundërvajtje

☐ Me të mitur

☐ Nuk e di (shpjego rastin me pak fjalë): HAPUR

2. Avokat apo përfaqësues i autorizuar

3. VETËM për shërbime administrative: dokumente, informata, pagesa, dhënia e deklaratës, etj.

4. Dëshmitar

5. Gazetar

6. Vëzhgues/Përkrahje të një të afërmi apo miku

7. Gjyqtar, Bashkëpunëtor Profesional

8. Prokuror, Bashkëpunëtor Profesional

9. Personel administrativ

10. Punoj në gjykatë, por jo në detyrë profesionale

Tjetër (specifikoni): _____

TRANSPARENCA / QASJA NË INFORMATA

Përvoja e respondentëve me qasjen në gjykatë

QASJA NË INFORMATA

P.2	Sipas përvojës suaj, sa është e lehtë që të merrni informata nga gjykata për rastin tuaj?	1. Tejet e vështirë 2. Deri diku e vështirë 3. Deri diku e lehtë 4. Tejet e lehtë
P.3	Sa ishin të dobishme informatat që u janë dhënë nga gjykata?	1. Tejet të padobishme 2. Deri diku të padobishme 3. Deri diku të dobishme 4. Tejet të dobishme
P.4	A ishte e lehtë të gjeni gjykatoren apo zyrën që ju duhej?	1. Tejet e vështirë 2. Deri diku e vështirë 3. Deri diku e lehtë 4. Tejet e lehtë
P.4a	Cka do të ndihmonte në këtë aspekt?	E HAPUR
P.5	A ka gjykata kuti të ankesave?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e di
P.6	A ka gjykata kënd informativ?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e di
TRANSPARENCA		
P.7	A e përdorni faqen e internetit të gjykatës si burim informacioni?	1. Po 2. Jo Nëse kod 2, vazhdoni tek P.8.

P.7a	A është përmbajtja e faqes së internetit në gjuhën tuaj amtare?	1. Po 2. Pjesësisht 3. Jo
Nëse kodi 2, vazhdoni te P.8.		
P.7b	A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit të përmbajtjes së faqes së internetit?	1. Po 2. Jo 3. Deri diku
P.7c	Çfarë informacioni kërkonit zakonisht në faqen e internetit të gjykatës?	(Mund të zgjedhni më shumë se një opsion) 1. Orarin e seancave 2. Kontaktet 3. Lajme 4. Vendime të publikuara 5. Informata për gjykatësit 6. Tjetër (specifikoni): _____

EFIKASITETI DHE PAANSHMËRIA

Përvoja e respondentëve me shërbimet e gjykatës

EFIKASITETI

P.8	A keni kryer punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme sot?	1. Po 2. Jo
P.9	Qe sa kohë është i hapur rasti i juaj?	1. Më pak se 6 muaj 2. Qe 1 vit 3. Qe 2 vjet 4. Më shumë se 2 vjet 5. Më shumë se 5 vjet 6. Më shumë se 10 vjet
P.10	A jeni të kënaqur me kohën që ka marrë (po merr) shqyrtimi i rastit tuaj?	1. Tejet i pakënaqur 2. Deri diku i pakënaqur 3. Deri diku i kënaqur 4. Tejet i kënaqur

PAANSHMËRIA

P.11	A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt nga stafi i gjykatës?	1. Po 2. Jo 3. Deri diku
-------------	---	--------------------------------

P.12	A vlerësoni që jeni trajtuar fer nga gjykatësi?	1. Po 2. Jo 3. Deri diku
P.13	A ju është dhënë mundësia që të flisni në gjuhën tuaj amëtare me stafin e gjykatës?	1. Po 2. Jo
P.14	A ka ofruar gjykata përkthim gjatë seancave?	1. Po 2. Jo Nëse kodi 2, vazhdoni te P.15.
P.14a	A jeni të kënaqur me kualitetin e përkthimit gjatë seancave?	1. Shumë i pakënaqur 2. Deri diku i pakënaqur 3. Deri diku i kënaqur 4. Shumë i kënaqur
P.15	A i pranoni/merrni dokumentet nga gjykata në gjuhën tuaj amëtare?	1. Po 2. Ndonjëherë 3. Jo
P.16	A ndjeheni (fizikisht) të sigurtë në objektin e gjykatës?	1. Po 2. Jo Nëse kodi 1, vazhdoni te P.17.
P.16a	Nëse jo, pse nuk ndjeheni të sigurtë?	E HAPUR
P.17	A jeni të informuar se mund të ankoheni për shkelje disiplinore të gjykatësit?	1. Po 2. Jo Nëse kodi 2, vazhdoni te P.18.
P.17a	Nëse po, a e dini se ku mund të ankoheni?	E HAPUR

PREVALENCA E KORRUPSIONIT

P.18 A ju është kërkuar ndonjëherë ryshfet nga ndonjë gjyqtar ose punonjës i gjykatës ose ndonjë ndërmjetësues në emër të tyre?

1. Po

2. Jo

Nëse kodi 2, vazhdoni te P.19.

P.18a Nëse po, për çfarë arsye?

(Mund të zgjedhni më shumë se një opsion)

☐ Për t'i përshpejtuar proceset

☐ Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm

☐ Që lënda të vendoset në favor timin

☐ Tjetër (specifikoni): _____

P.18b Nëse po, çfarë posti mban personi?

1. Gjyqtar

2. Punonjës i gjykatës

3. Tjetër (specifikoni): _____

P.19 Have you ever offered a bribe to a judge or court employee?

1. Po

2. Jo

Nëse kodi 2, vazhdoni te P.20.

P.19a Nëse po, për çfarë arsye?

(Mund të zgjedhni më shumë se një opsion)

☐ Për t'i përshpejtuar proceset

☐ Për të marrë dokumentacionin e nevojshëm

☐ Që lënda të vendoset në favor timin

☐ Tjetër (specifikoni): _____

P.19b Nëse po, çfarë posti mban personi?

1. Gjyqtar

2. Punonjës i gjykatës

3. Tjetër (specifikoni): _____

PYETJE PËRMBYLLËSE

P.20 A keni ndonjë gjë për të shtuar?

E HAPUR

Programi i USAID për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë është program pesëvjeçar i sundimit të ligjit që bazohet në përpjekjet e mëparshme të USAID-it për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe për të siguruar që sistemi i drejtësisë të funksionojë në një mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënëse. Programi përqendrohet në promovimin e një sistemi gjyqësor që i përmbahet standardeve të larta të pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës, si dhe në mbështetjen e funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në veri.

Ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në ndarjen e drejtësisë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore

Përmes USAID-it, Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat e Kosovës në konsolidimin e përfitimeve në efikasitet dhe menaxhim në nivelin e gjykatave. Kjo është arritur duke lehtësuar decentralizimin e kompetencave administrative dhe institucionalizimin e sistemeve dhe mjeteve për menaxhimin efektiv të gjykatave dhe çështjeve. Aktivitetet nën këtë objektiv zvogëlojnë prapambetjen e çështjeve dhe pengesat procedurale për efikasitetin dhe efektivitetin e gjykatës.

Përmirësimin e llogaridhënies dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë


Programi punon ngushtë me KGJK-në, gjykatësit dhe stafin e gjykatës në ndërtimin e aftësive për të ofruar drejtësi në mënyrë profesionale dhe efikase. Ai gjithashtu promovon arsimimin e vazhdueshëm dhe iniciativat e integritetit publik si bazë për një gjyqësor që është i arritshëm, i besueshëm dhe efektiv.

Mbështetjen e funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në veri

Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë mbështet KGJK dhe gjykatat në aktivizimin e strukturave gjyqësore në veri të Kosovës bazuar në Marrëveshjen e Sektorit të Drejtësisë që u nënshkrua në mes qeverive të Kosovës dhe Serbisë në vitin 2015. Kjo marrëveshje parashikon integrimin e institucioneve, operacionet gjyqësore dhe burimet gjyqësore në veri. Ky program i USAID gjithashtu ndihmon gjykatat individuale në rajon me inventarët e çështjeve dhe transferimet, uljen e numrit të lëndëve të grumbulluara të pakryera, menaxhimin e çështjeve dhe krijimin e kapaciteteve për gjyqtarët dhe stafin e gjykatës.

Demokraci Plus është organizatë e pavarur, jofitimprurëse dhe jopartiake e themeluar nga një grup aktivistësh që besojnë në forcimin e mëtejshëm të vlerave demokratike në Kosovë. Qëllimi kryesor i D+ është të nxisë vlera dhe praktika demokratike që do të forcojnë më tej zërin e shoqërisë kosovare. D+ synon të kontribuojë në krijimin e praktikave të qeverisjes së mirë, forcimin e sundimit të ligjit, ndihmesën partive politike dhe procesin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, dhe nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe çështjeve sociale. D+ ka realizuar projekte të ndryshme që synojnë t'i sjellin vendimmarrësit më afër qytetarëve përmes hulumtimit të politikave, lehtësimit të dialogut dhe ndërveprimit si dhe edukimit publik.

Qendra e Avokatisë për Kulturë Demokratike është organizatë vendore e shoqërisë civile (OSHC), me seli në Mitrovicën e Veriut, Kosovë, e cila është themeluar në dhjetor të viti 2011. Qëllimi i organizatës është të përmirësojë angazhimin e një popullate shumëetnike në rajonin e Mitrovicës dhe të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për kulturën demokratike.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



ACDC
Advocacy Center For Democratic Culture